



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

I. Br: 400-01/28567, dana: 29.maja 2025.godine

Na osnovu člana 12, člana 12.2 slovo d) Zakona Br.03/L – 040 o Lokalnoj Samoupravi Republike Kosovo, člana 22 stav 1 tačka 1.6 Administrativnog Uputstva MALV-a br. 04/2023 o Otvorenoj Administraciji u Opštinama, člana 20, stav 1 tačka 1.4 Statuta Opštine Peć, I.br. 01-016/01-413431 od 30. Septembra 2020.godine, člana 39 stav 1 Pravilnika br.02/2021 o Radu Skupštine Opštine Peć, I. Br: 01-060/017031 od 09. 03.2021, Skupština Opštine Peć je, na sednici održanoj dana 29. maja 2025. Godine, posle postupka javne rasprave o nacrtu Strategije za Razvoj Turizma 2026-2030, donela ovu:

ODLUKU

Br.36/2025

Strategija za Razvoj Turizma 2026-2030

- 1. USVAJA SE Strategija za Razvoj Turizma 2026-2030.**
2. Sastavni deo ove odluke je Strategija za Razvoj Turizma 2026-2030.
3. Za primenu ove odluke zadužen je Direktor za Ekonomski Razvoj, počevši od 01.januara 2026. Godine.
4. Ova odluka će biti objavljena 30 dana posle registracije u Kancelariji za Protokolisanje u MALV-u, kao i 7 dana posle objavljivanja na službenim jezicima na web stranici Opštine Peć.

Odluka se dostavlja:

MALV-u,
Gradonačelniku Opštine,
Direktoratu za Administraciju,
Arhivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT 2026-2030

Maj, 2025

Përmbajtja

Figurat dhe Tabelat	2
Akronimet	4
1. Hyrja dhe sfondi	5
2. Trendet globale të turizmit	7
3. Metodologjia dhe procesi	8
4. Prioritizimi i rrjedhave të vizitorëve	9
5. Analiza SWOT	120
6. Hartëzimi i akterëve dhe funksioneve kryesore	121
6.1. Akterët parësor	131
6.2. Shërbimet mbështetëse aktive	153
6.3. Ambienti mundësues	175
7. Pasqyra e rrjedhave të vizitorëve	20
8. Vizioni	356
9. Veprimet e propozuara	38
9.1. Rrjedha e informacionit dhe promovimi	38
9.2. Transporti	39
9.3. Atraksionet kulturore-historike	39
9.4. Infrastruktura	40
9.5. Ngritja e kapaciteteve njerëzore	41
9.6. Produktet dhe aktivitetet turistike	42
9.7. Tjera	42
10. Plani i punës	465
11. Matja e performancës dhe implementimi	52
Shtojcat	54
Shtojca A	54

Figurat dhe Tabelat

Figura 1: Analiza SWOT për sektorin e turizmit në Pejë.....	120
Figura 2: Akterët dhe funksionet relevante të turizmit.....	121
Tabela 1: Kriteret e vlerësimit të rrjedhave potenciale të vizitorëve.....	9
Tabela 2: Prioritizimi i rrjedhave të vizitorëve.....	9
Tabela 3: Pasqyra e rrjedhave të vizitorëve.....	20
Tabela 4: Indikatorët për matje të performancës.....	52

Akronimet

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AZHR	Agjencia për Zhvillim Rajonal
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Europiane për Ri-ndërtim dhe Zhvillim
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MZHR	Ministria për Zhvillim Rajonal
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PP	Pa Përcaktuar
PPSE	Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat
QRTK	Qendra Rajonale për Zhvillim të Turizmit
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
RV	Rrjedha e Vizitorëve
SDC	Agjencia Zvicrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SGDM	Modeli i St.Gallen për menaxhim të destinacionit
SWOT	Përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet
UTK	Unioni i Turizmit të Kosovës
UNWTO	Organizata Botërore për Turizëm e Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar
WWF	Fondi Botëror për Mbrojtjen e Natyrës

I. Hyrja dhe sfondi

Komuna e Pejës shtrihet në pjesën veri-perëndimore të Kosovës dhe ka një sipërfaqe prej 603 km². Komuna e Pejës përbëhet nga qyteti i Pejës dhe 95 fshatra. Komuna kufizohet në perëndim dhe në veri nga Mali i Zi, në Veri-lindje nga Komuna e Istogut dhe Komuna e Klinës dhe në jug nga Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Deçanit. Karakteristikë e përgjithshme e pozitës së Pejës është se ajo shtrihet në skajin veri-perëndimor të luginës së plleshme të Dukagjinit, para grykës piktoreske të Rugovës, në Bjeshkët e Nemuna dhe masivin e Bjeshkëve Dinarike. Për nga numri i banorëve, renditet si qyteti i katërt më i madh në Kosovë me gjithsej 82,661 banorë të regjistruar.¹ Strukturën etnike e dominojnë shqiptarët me afërsisht 85%. Pjesa tjetër janë boshnjak, malazezë, romë, ashkali, serb dhe të tjerë.²

Peja njihet si qytet i lashtë që nga koha Ilire. Për shkak të luftërave të shumta në këtë rajon, që nga pushtimi Otoman e deri te kjo e fundit me Serbinë, nuk është mundur të ruhet e gjithë karakteristika ilire, ku përveç tjerash pësoi edhe Kalaja e Pejës.

Në kohën Ilire ishte një qendër e madhe vendbanimi. Sipas hulumtimeve arkeologjike ky qytet kishte edhe një kala, mbi gërmadhat e lashta të së cilës është ngritur fabrika e baterive.

Rajoni i Pejës është njëri ndër tri destinacionet e Kosovës me më së shumti vizitorë. Vlerësimet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, tregojnë se numri i vizitorëve në vitin 2023 ishte 153 803 vizitorë (vendor dhe të jashtëm) me gjithsej fjetje të shpenzuara 659,948 netë. Ndonëse nuk ka të dhëna të sakta për vizitorët një ditë, sipas disa vlerësimeve të akterëve të turizmit në këtë Komunë, numri i tyre total për 1 vitë është diku rreth 150,000-200,000. Sa i përket vendit të origjinës, nga rajoni dominojnë shqiptarët e Shqipërisë, Malit të Zi, përderisa nga vendet tjera përtej rajonit, dominojnë Gjermanët, Italianët, Polakët, Çekët, Zvicranët, Turqit, Austriakët, USA, Australia etj.

Sipas statistikave të ofertës së akomodimeve të prezantuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në vitin 2023, Peja kishte gjithsej 99 njësi akomoduese. Më shumë njësi operojnë vetëm në Prishtinë (158).³ Për nga numri i dhomave dhe shtretërve, Peja radhitet e dyta (pas Prishtinës) me gjithsej 1,746 dhoma dhe 3,701 shtretër. Komuna e Pejës ka arritur të ketë një ofertë të larmishme të llojeve të akomodimit për turistë, ndërsa për nga numri i njësive akomoduese, radhitet e dyta pas asaj të Prishtinës. Numri më i madh i njësive akomoduese gjendet në qytetin e Pejës dhe në afërsi, ku tani funksionojnë së paku 15 hotele dhe një numër i konsiderueshëm i restoranteve. Kapacitetet akomoduese nuk janë të mjaftueshme në krahasim me kërkesat e vizitorëve dhe interesimi për të investuar në këto lokalitete është i madh, kryesisht në ndërtim të villave për qiradhënie, hotele dhe motele.

Ofertës akomoduese ende i mungojnë hapësirat për kampim, për të cilat ka interesim të madh nga vizitorët por që ende janë në zhvillim e sipër.⁴

¹ ASK (2024). Regjistrimi i Popullsisë.

² Ibid.

³ ASK (2023). Statistikat e Hotelerisë dhe Turizmit 2023

⁴ Plani Zhvillimor Komunal 2020-2028

Të gjitha këto statistika dhe kjo fotografi e përgjithshme tregojnë se Peja është në mesin e destinacioneve atraktive për turizëm në Kosovë. Të njëjtat gjithashtu sugjerojnë se ka shumë mundësi për zhvillim të mëtutjeshëm të sektorit.

Duke i vlerësuar potencialet me të cilat disponon Peja dhe duke e parë mundësinë e zhvillimit të turizmit si një sektor i përshtatshëm për zhvillimin e komunës së Pejës, në planin zhvillimor komunal është paraparë turizmi si një nga shtyllat kryesore për zhvillim. Me këtë komuna ka marrë iniciativën për themelimin e sektorit të turizmit në komunë të cilën e ka bërë që nga viti 2003 dhe është nga komunat e para në Kosovë që disponon me një sektor të tillë që nga ajo kohë.⁵

Njëri prej parakushteve për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të turizmit është hartimi i një strategjie, e cila i përcakton orientimet zhvillimore të këtij sektori. Duke e parë këtë nevojë, Komuna e Pejës, përkatësisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, me ndihmën e akterëve të turizmit, janë angazhuar për të përpiluar një strategji të turizmit që përfshinë periudhën 2025-2029.

Strategjia bazohet në një metodologji bashkëkohore për menaxhim të destinacioneve, e cila është zhvilluar nga Universiteti Zvicëran St. Gallen. Kjo metodologji kryesisht bazohet në rrjedha ekzistuese të vizitorëve dhe ofron propozime praktike për adresim të sfidave aktuale. Përmes kësaj strategjie, mes tjerash, do të tentohet që të nxitet ardhja e më shumë vizitorëve, të rritet kohëzgjatja e qëndrimit të tyre dhe shpenzimet e tyre, duke iu ofruar shërbime kualitative turistike.

Përmbajtja është siç vijon: Seksioni 2 ofron statistika të turizmit në aspekt global dhe shpalos trendët kryesore në këtë nivel. Seksioni 3 shpjegon gjithë procesin e hartimit të kësaj strategjie. Seksioni 4 renditë një listë potenciale të rrjedhave të vizitorëve dhe shfaq përzgjedhjen e atyre me prioritet. Seksioni 5 prezanton analizën e përgjithshme SWOT, ku përfshihen përparësitë dhe dobësitë në njërin anë, si dhe mundësitë dhe kërcënimet në anën tjetër. Seksioni 6 ofron një hartëzim të të gjithë akterëve dhe funksioneve relevante të turizmit në Pejë, përfshirë edhe mbështetësit aktiv në nivel lokal dhe qendror, si dhe ambientin rregullues. Seksioni 7 prezanton një pasqyrë të rrjedhave të përzgjedhura të vizitorëve, duke u fokusuar te profili, motivi i vizitës, ndikuesit, përparësitë dhe gjërat që funksionojnë, si dhe sfidat kryesore. Seksioni 8 përshkruan vizionin e përbashkët për zhvillim të sektorit të turizmit. Seksioni 9 përfshinë veprimet e propozuara për adresim të sfidave/mungesave dhe nevojave kryesore të turizmit. Seksioni 10 prezanton planin e punës. Në fund, Seksioni 11 ofron disa indikatorë për matje të zhvillimit të turizmit dhe progresit të përgjithshëm në zbatim të strategjisë, ku mes tjerash, propozohet edhe mekanizmi që garanton implementimin.

⁵ <https://kk.rks-gov.net/peje/zhvillimi-ekonomik/sektori-i-turizmit/>

2. Trendet globale të turizmit

Turizmi është një industri dinamike dhe në zhvillim që reflekton ndryshimet globale sociale, ekonomike, teknologjike dhe mjedisore.

Sipas Barometrit të parë Botëror të Turizmit të UNWTO-s, turizmi ndërkombëtar e mbylli vitin 2023 në 88% të niveleve të para pandemisë, me rreth 1.3 miliardë ardhje ndërkombëtare. Rritja e kërkesës, rritja e numrit të fluturimeve dhe një rimëkëmbje më e fortë e tregjeve dhe destinacioneve aziatike, pritet të mbështesin një rimëkëmbje të plotë deri në fund të 2024-ës⁶.

Turizmi i qëndrueshëm po rritet me shpejtësi, me eko-turizmin që tani përbën 15% të tregut global të udhëtimeve. Një sondazh nga Booking.com në vitin 2023 gjeti se 76% e udhëtarëve globalë shprehën dëshirën për të qëndruar në akomodime të qëndrueshme.⁷

Nga viti 2020 deri në vitin 2022, udhëtimet e mirëqenies janë rritur me 30.2% në vit dhe shpenzimet janë rritur me 36.2% në vit. Tregu global i turizmit të mirëqenies parashikohet të rikuperohet plotësisht dhe të tejkalojë nivelin e tij para pandemisë që nga viti 2023, me norma të rritjes vjetore të parashikuara prej 14.7% për udhëtimet e shëndetit dhe 16.6% për shpenzimet e udhëtimeve të mirëqenies deri në vitin 2027.⁸

Turizmi si sektor ka shënuar transformimet e veta në nivele të ndryshme. Më poshtë, janë të paraqitura trendet kryesore të zhvillimit të këtij sektori në botë sot:

Përjetimi/Eksperienca

Sot, turistët kërkojnë më shumë sesa thjesht të vizitojnë një destinacion – ata janë në kërkim të përvojave që ngjallin emocion, frymëzim dhe një lidhje të thellë me vendin që po eksplorojnë. Për ta, udhëtimi nuk është më një aktivitet sipërfaqësor, por një mundësi për t'u zhytur në kulturën, traditat dhe historinë unike të një destinacioni. Aktivitetet interaktive, aventurat autentike dhe momentet e paharrueshme janë ato që e bëjnë një udhëtim të veçantë dhe kuptimplotë. Në turizmin modern, krijimi i përvojave të personalizuar dhe autentike ka marrë një rëndësi thelbësore, duke e kthyer udhëtimin në një rrugëtim për të krijuar kujtime që zgjasin përjetësisht.

Transformimi digjital

Përcaktimi për destinacionet dhe rezervimet në të shumtën e rasteve bëhen përmes platformave online (booking.com,

⁶ <https://www.unwto.org/news/international-tourism-to-reach-pre-pandemic-levels-in-2024>

⁷ <https://www.gstcouncil.org/booking-com-2023-sustainable-travel-report/>

⁸ <https://globalwellnessinstitute.org/global-wellness-institute-blog/2024/03/25/a-decade-of-wellness-tourism-first-ever-compilation-of-10-years-of-market-data/>



tripadvisor, trivago, airbnb, etj.). Tregu i udhëtimeve në internet u vlerësua në 744.73 miliardë dollarë në 2022 dhe parashikohet të arrijë në 1,835.6 miliardë dollarë deri në vitin 2032, duke u rritur me një normë vjetore të rritjes (CAGR) prej 9.8% nga 2023 në 2032.

Transformimet digjitale kanë ofruar mundësi që konsumatorët të kenë më të lehtë t'i ndajnë përshtypjet e tyre përmes vlerësimeve online. Kjo në njërën anë e bën që të reduktohet asimetria e informacionit në anën e kërkesës dhe njëkohësisht i nxit ofertuesit t'i përmirësojnë produktet dhe shërbimet e tyre.

Siguria

Siguria është njëri nga aspektet më vitale në promovim dhe zhvillim të turizmit. Suksesi i një destinacioni turistik varet nga aftësia e vendit për të ofruar ambient të sigurt për vizitorët. Kjo çështje është bërë edhe më e rëndësishme në vitet e fundit me përhapjen e akteve terroristë dhe epidemive të ndryshme.

Duhet theksuar se përveç sigurisë fizike, në ditët e sotme mbrojtja dhe integriteti i të dhënave, siguria në ushqim dhe në shëndet në përgjithësi janë aspekte përcaktuese për t'i bindur turistët ta vizitojnë një vend.

Qëndrueshmëria

Aspekti i qëndrueshmërisë është bërë aq i rëndësishëm sa që kohëve të fundit po organizohen edhe protesta në rrugë për ta ndaluar mbi-turizmin, i cili në formë të pakontrolluar po degradon destinacionet turistike.

Si rezultat i këtij frustrimi, gjithnjë e më shumë

është duke u punuar që të zhvillohen praktika që promovojnë sjellje të qëndrueshme, e cila e mbrohet ambientin dhe banorët lokal, duke mos i sakrifikuar të hyrat nga turizmi.

Tregjet e reja

Tregjet aziatike: ritmi i shpejtë i zhvillimit ekonomik, hapja e tregut, dhe lehtësirat e ofruara në udhëtim, kanë bërë që Azia të bëhet ndër tregjet me të mëdha të turizmit në botë. Në nivel të shteteve, Kina është burimi kryesor me rritjen më të shpejtë të turistëve të jashtëm, dhe që nga 2012 është shpenzuesi më i madh në turizmin ndërkombëtar.

Mijëvjeçarët⁹: të nxitur nga udhëtimet të mbushura me përvoja si dhe nga rrjetet sociale, mijëvjeçarët janë shndërruar në një kategori të turistëve që kanë rol të rëndësishëm në formësimin e turizmit në botë.

Llogaritet që ata shpenzojnë rreth 200 miliardë dollarë në vit për udhëtime.

Të moshuarit (60+): të moshuarit janë udhëtarë mjaft intenziv dhe segment genësor i turizmit në botë. Në mesatare, përbëjnë rreth 25% të turizmit ndërkombëtar. Ata synojnë të kuptojnë më shumë mbi historinë e vendeve dhe të kenë mundësi për socializim.

⁹ Mijëvjeçarët (Millennials), të njohur edhe si brezi Y, janë personat e lindur midis viteve 1981 dhe 1996.

3. Metodologjia dhe procesi

Për ta hartuar këtë strategji, ekipi është bazuar në “Modelin e St.Gallen për menaxhim të destinacionit” (SGDM), si një qasje alternative për t’i kuptuar sjelljet dhe dinamikat komplekse të turistëve. Në bërthamën e saj, kjo qasje ka analizimin e rrjedhave strategjike të turistëve, duke synuar që t’i shpjegojë faktorët që ndikojnë në sjellje të caktuar të turistëve dhe ndërlidhjet që e përcaktojnë kërkesën dhe ofertën.

Metodologjia në fjalë është zhvilluar duke u bazuar në përvoja praktike nga 30 destinacione turistike dhe nga zhvillimet e fundit në menaxhim të destinacionit. Gjatë viteve të fundit, kjo metodologji është duke u promovuar dhe implementuar suksesshëm nga Swisscontact-i në projektet e saja zhvillimore nëpër botë.

Shikuar në përgjithësi, ky model ka pasur një rol kyç në pasqyrimin e turizmit në Komunën e Pejës, veçanërisht në identifikimin e profilit dhe sfidave të turistëve. Gjatë aplikimit të saj, kjo metodologji është modifikuar dhe plotësuar me mjete metodologjike shtesë, për t’iu përshtatur kontekstit dhe specifikave të vendit.

Më poshtë përshkruhen hapat kryesorë të procesit të hartimit të strategjisë, nga fillimi deri në përfundim. Gjatë gjithë këtij procesi është konsultuar literatura, për të kuptuar më shumë mbi praktikën e suksesshme ndërkombëtare.

1. Si hap i parë, është zhvilluar një takim me Drejtorin dhe stafin përgjegjës të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, për të shkëmbyer idetë fillestare rreth strategjisë së re për turizëm të Komunës së Pejës.

2. Punëtori të organizuara me zyrtarët komunal, tour-operatorët, pronarët e akomodimeve dhe restoraneve, përfaqësues të OJQ-ve lokale, etj, me qëllim të informimit të tyre mbi metodologjinë, mbledhjes së të dhënave mbi sjelljen e rrjedhave të ndryshme të turizmit dhe për ta përcaktuar vizionin e përgjithshëm të turizmit të Pejës.

3. Intervista me akterët lokal të turizmit.

4. Prioritizimi i rrjedhave të vizitorëve

Në mënyrë që veprimet e propozuara të strategjisë të jenë sa më të konkretizuara, ka qenë e nevojshme që të përzgjidhen rrjedhat e vizitorëve me më së shumti potencial në Komunën e Pejës. Në bashkëpunim me DZHE dhe akterët relevant, janë identifikuar 7 kritere dhe janë peshuar sipas rëndësisë së tyre (shih Tabelën 1). Më tutje, përfaqësuesit e DZHE-së së bashku me akterë tjerë të turizmit, janë ftuar që të bëjnë vlerësimin e secilës rrjedhë të vizitorëve karshi

kritereve me nota nga 1 deri në 5, ku 1 - mungesë potenciali, ndërsa 5 - potencial të plotë. Në fund, vlerësimet individuale janë peshuar dhe është gjeneruar një mesatare e përgjithshme.

Tabela 1: Kriteret e vlerësimit të rrjedhave potenciale të vizitorëve

Kriteret e vlerësimit	Peshimi
Potenciali për rritje të numrit të vizitorëve	20%
Potenciali për të shpenzuar	20%
Potenciali për gjenerim të vendeve të punës (për të rinj dhe gra)	20%
Potenciali për qëndrueshmëri ekonomike, socio-kulturore dhe ambientale	15%
Potenciali për angazhim të akterëve të turizmit	10%
Ndërlidhja me synimet strategjike të qytetit	10%
Potenciali për zhvillim të suksesshëm të intervenimeve	5%

Tabela 2 paraqet renditjen e të gjitha rrjedhave të vizitorëve sipas vlerësimeve të bëra nga akterët e turizmit në Komunën e Pejës. Nga të gjitha rrjedhat potenciale, vetëm 7 të parat, të cilat kanë vlerësim mesatar mbi 70%, do të trajtohen më tutje në këtë strategji. Duhet potencuar se renditja nuk luan ndonjë rol të veçantë në veprimet e propozuara, sepse qëllimi kryesor i këtij vlerësimi ka qenë ndarja e rrjedhave me më shumë prioritet prej atyre me më pak prioritet.


Tabela 2: Prioritizimi i rrjedhave të vizitorëve

Rrjedhat e vizitorëve		Mesatarja e vlerësimeve
R V 1	Turizmi i aventurës, bjeshkataria, alpinizmi, Via Ferrata, Shpella, Zip Line, Paragliding, Çiklizmi malor dhe fushor, ecje papuqe bore, ski, ski toruing	86%
R V 2	Festivalet dhe ngjarjet e tjera	85%
R V 3	Vizitorët ditorë për Trashëgimi Kulturorë, Çarshinë e Gjatë dhe Zejet	71%
R V 4	Eksplorim dhe ecje në natyrë	71%
R V 5	Vizitorët nga diaspora, familjarët dhe shoqëria	70%
R V 6	Turizmi rural	70%
R	Turizmi shëndetësor	70%

5. Analiza SWOT

Analiza SWOT ofron një pasqyrë të përgjithshme të përparësive dhe dobësive të sektorit të turizmit në Pejë, dhe njëkohësisht i nxjerr në pah mundësitë përkatësisht kërcënimet kryesore.

Figura 1: Analiza SWOT për sektorin e turizmit në Pejë



6.1. Akterët parësor

Tour-operatorët

Nga afërsisht 30 tour-operatorë të licencuar në gjithë Kosovën, pesë prej tyre e kanë Pejën si destinacion kryesor¹⁰. Itineraret dhe gjatësia e toureve është kryesisht fleksibile dhe vendoset në bashkëpunim me vizitorët sipas interesave dhe kohës që kanë në dispozicion. Duhet theksuar se ka edhe itinerare të parapërcaktuara, të vendosura në web-faqet e tyre. Ekzistojnë mbi 120 guida të certifikuara (në nivel të Kosovës)¹¹, trajnime të cilat janë bërë në periudha të ndryshme kohore dhe nga donatorë të ndryshëm. Fluksi më i madh i vizitorëve vjen nga tour-operatorët rajonal, kryesisht të vendosur në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut. Disa prej tyre – në fakt një numër i vogël – i angazhojnë guidat lokale, për shkak të marrëveshjeve fillestare që bëjnë me guidat e huaja. Sidoqoftë, situata pritet të ndryshojë për mirë pasi tashmë ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ (MINT) 06/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Regjistrimit dhe Ushtrimit të Veprimtarisë së Udhërrëfyesve Turistik, i cili specifikon qartë se “nuk lejohet operimi i udhërrëfyesve turistikë të huaj brenda territorit të Republikës së Kosovës pa shoqërimin e një udhërrëfyesi turistik vendor të regjistruar në MINT”.

Transporti

Transporti urban në Pejë aktualisht nuk funksionon, ndërsa transporti ndërrurban drejt fshatrave sigurohet nga kompani private. Në qytet operon edhe shërbimi i trenit, të cilin komuna e mbështetë, së bashku me kompanitë e taksive që ofrojnë shërbime për qytetarët dhe vizitorët. Po ashtu, duhet të përmendet se aeroporti më i afërt është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, i cili luan një rol kyç në lidhjen e rajonit me destinacionet ndërkombëtare.

Akomodimet

Në gjithë regjionin e Pejës në vitin 2023 kanë operuar 99 njësi akomoduese, me 1,746 dhoma dhe 3,701 shtretër¹². Shikuar sipas statusit ligjor, shumica e tyre, janë biznese individuale. Në ndërkohë, janë shtuar rreth 75 AirBnB apartamente. Prej të gjitha akomodimeve, rreth 85% e tyre kanë edhe nga një restorant si pjesë të integruar të biznesit. Numri i përgjithshëm i të punësuarave në njësi akomoduese me restorane në vitin 2022 ishte 546¹³.

Atraksionet

Atraksionet kulturore-historike

Në qytetin e Pejës dhe rrethinës gjendet një numër i madh i objekteve kulturo-historike, të cilat shprehin kulturën dhe traditën e kësaj komune, që nga kohërat ilire e deri në ditët e sotme. Ekzistojnë shumë objekte me vlera historike, siç janë: kullat e gurit, shtëpitë e vjetra, objektet religjioze, siç janë: xhamitë, kisha katolike dhe ortodokse, teqetë, pastaj hamami i Haxhi Beut, mulliri i Haxhi Zekës, kompleksi i Çarshisë së Vjetër, si dhe objekte të tjera që qytetit të Pejës i japin një histori të vjetër të zhvillimit në periudha të ndryshme kohore. Janë të gjitha këto objekte

¹⁰ <https://visitkosovo.rks-gov.net/page/tour-operatoret>

¹¹ Info nga GuideKS

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës (2023). Kapacitete hoteliere në Kosovë sipas regjionit

¹³ Anketa e Ofertës së Turizmit 2022, <https://ppsekosovo.org/sq/raporte/>

që karakterizohen me ndërtime arkitektonike nga mjeshtërit e kohërave të vjetra, të cilët kanë punuar ndërtime nga guri dhe druri.

Prandaj, është e pashmangshme që të vizitohet qyteti i Pejës e të mos kalohet nëpër pika interesante, që të dërgojnë në kohëra të ndryshme.

Artizanatet

Qyteti i Pejës njihet qysh nga kohërat e hershme, si qytet tregtar dhe artizanal. Artizanatet më të njohura janë: argjendaria, punimi i qelesheve, farkëtaria, saraçët etj. Pra, ka një numër të madh të artizaneve, që janë punuar me një përkushtim të madh nga mjeshtërit, të cilët punën e tyre e kanë bartur brez pas brezi deri në ditët e sotme.

Natyra dhe ambienti

Komuna e Pejës njihet si qytet ekologjik me më se 70% të sipërfaqes të mbuluar me gjelbërim. Është regjioni malor i Rugovës, i cili e përbën pjesën më të madhe me gjelbërim, duke përfshirë mbi 52% të sipërfaqes dhe njëherit njihet edhe si freskia e qytetit të Pejës. Ka atraksione, bukuri dhe pasuri të shumta natyrore, duke u nisur nga Gryka piktoreske e Rugovës, lumenjtë, liqenet në lartësi prej 1860 m, burimet ujore, ujëvarat, shpellat, si dhe shumëllojshmëria e florës dhe faunës. Po ashtu, brenda qytetit, pothuajse në çdo kënd, ekzistojnë oazat e gjelbëruara, të cilat ia shtojnë bukurinë qytetit, mbajnë ajrin e freskët dhe mundësojnë relaksim të qytetarëve.

Festivalet

Qyteti i Pejës njihet për organizim të festivaleve kulturore, të cilat gjenerojnë shumë vëmendje, disa prej tyre madje edhe ndërkombëtare. Festivali ndërkombëtar i filmave të animuar “Anibar”, “Peja Outdoor Tourism Festival”, festivali i muzikës Jazz, Lojërat Tradicionale në Rugovë, janë disa nga ngjarjet tradicionale që organizohen në Komunën e Pejës.

Aktivitetet

Në rajonin e Pejës, organizohen një sërë aktivitesh aventureske për t'u kujdesur për entuziastët e natyrës. “Parku i Aventurave” është i pari vend argëtimi dhe aventure i kësaj natyre në Kosovë, por edhe në rajon. Në këtë park vizitorët kanë mundësinë të shijojnë një sërë platformash ajrore të kategorizuara sipas nivelit të vështirësisë, luhajën e madhe (big swing) me lartësi prej 17 metrash, ecjen në shkallë me litarë, kalërimin dhe aktivitete të tjera në natyrë.

Eksplorimi i Grykës së Rugovës, që ka shtigje të shënuara mirë, Shtegu “Majat e Ballkanit” i cili mundëson një udhëtim shumë-ditor nëpër Alpet Dinarike, pastaj Via Dinarica që kalon nga tri komuna, që lidh Kosovën, Malin e Zi dhe Shqipërinë, Zip Line në Grykën e Rugovës, paragliding, eksplorimi i Shpellës së Radacit, Via Ferrata, çiklizmi, skijimi etj. Këto ngjarje dhe aktivitete promovojnë bukurinë natyrore dhe trashëgiminë kulturore të rajonit të Pejës.

Aventura e çiklizmit në qytet ku turistët mund ta vizitojnë shtegun kulturor i cili përmban 14 pika të trashëgimis kulturore ndërsa aventura malore e çiklizmit është gjithashtu shumë atraktive. Mund të filloni nga qyteti i Pejës për të vazhduar pastaj përgjatë Grykës së Rugovës e cila është zonë nën mbrojtje me ligj për shkak të vlerave të saja natyrore dhe peizazhore, për të vazhduar pastaj në bjeshkët e Rugovës apo edhe në territorin e parkut nacional Bjeshkët e Nemuna.

Via Ferrata është gjithashtu një aktivitet që ofron përvojë dhe adrenalinë dhe është shumë i kërkuar nga vizitorët që vizitojnë Pejë.

Ecja malore është një nga aktivitetet më të popullarizuara në rajonin perëndimor të Kosovës ndërsa Peja veçohet për këtë me një traditë shumë të hershme duke filluar nga vitet 1928 me organizimin e shoqërisë së parë në Kosovë me emrin Gjeravica.

Speleologjia është një aktivitet që në Pejë ka filluar të zhvillohet mjaft heret dhe ka një bagazh të madh në këtë dretim si në hulumtimet e shpellave ashtu edhe udhëheqjen e grupeve turistike.

Fluturimi mbi qytetin e Pejës është një përvojë krejtësisht ndryshe nga përvojat e tjera rekreative të ofruara në destinacionin e Pejës.

Zip Line është një aktivitet rekreativ që zhvillohet me një fluturim përmes rrëshqitjes mbi fije metalike në gjatësi dhe lartësi të ndryshme. Zip Line në Pejë, e njohur si Marimangat gjendet në grykën piktoreske të Rugovës ose saktësisht në kilometrin e 4-të nga Peja në Grykën e Rugovës. Ski dhe Ecje me pauqe bore ku përveç Pejës e cila gjatë dimrit mbulohet me borë dhe sidomos nata shëndrohet në atraksion për qytetarët dhe vizitorët, është edhe zona malore e Rugovës e cila ofron eksperiencat më të bukura për të gjithë ata që vizitojnë Pejën e sidomos për adhuruesit e skive.

Restorantet

Në rajonin e Pejës operojnë mbi 70 restorante/vende ushqimi të qasshme për turistë. Krahesisht, ka më pak restorante/vende për ushqim se në rajonin e Prishtinës, Prizrenit, Ferizajt dhe Gjilanit. Duhet theksuar se në qytet ekziston një numër i limituar i restoranteve ekskluzive që shërbejnë ushqim tradicional. Për më shumë, një përqindje e papërfillshme e tyre ofrojnë hapësira për konferenca apo seminare.

6.2. Shërbimet mbështetëse aktive

Unioni i Turizmit të Kosovës (UTK)

Unioni i Turizmit të Kosovës me seli në Prishtinë është themeluar në vitin 2020 në Prishtinë. Qëllimi i themelimit të këtij unioni është forcimi dhe zhvillimi i sektorit të turizmit, me fokus në zhvillimin e sektorit privat të kësaj industrie.

Oda e Hotelarisë dhe Turizmit (OHTK)

Kjo odë është themeluar në vitin 2020 dhe qëllimi i OHTK-së, është përforsimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve lokale, qendrore dhe rajonale, për identifikimin e mënyrave dhe hapave për krijimin e një mjedisi të favorshëm për përfshirjen sa më të gjerë të bizneseve hoteliere dhe atyre turistike.

Asociacioni i Guidave Turistike të Kosovës (GUIDEKS).

Asociacioni i Guidave Turistike të Kosovës është asociacion i themeluar në Korrik 2018 nga një grup i udhërrëfyesve/guidave të certifikuar. GUIDEKS përfaqëson organizimin ombrellë të të gjithë guidave turistike në vend të profilit kulturor dhe natyror. Misioni kryesor është promovimi i Kosovës si destinacion turistik përmes guidave të kualifikuara turistike, duke përfshirë promovimin e trashëgimisë sonë kulturore dhe natyrore si burime të pandashme për zhvillimin e turizmit në vend; dhe promovimin e udhërrëfyesve/guidave profesional si dhe mbrojtjen e profesionit të tyre.

Federata e Bjeshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive e Kosovës

Federata e Bjeshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive e Kosovës përfaqëson dhe mbron interesat e shoqërive bjeshkatore alpiniste nga mbarë Kosova. Federata e Bjeshkatarisë dhe Ngjitjes Sportive e Kosovës, në vitin 2022 është anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Ngjitjes Sportive IFSC International Federation of Sport Climbing, dhe misioni kryesor i saj është promovimi dhe zhvillimi i këtij sporti, i cili tani më është pjesë e programit të lojërave olimpike.

Agjencia për Zhvillim Rajonal – Perëndim (AZhR-Perëndim)

AZhR-Perëndim është institucion që luan një rol kyç në promovimin dhe zbatimin e projekteve për zhvillim të qëndrueshëm dhe përparim ekonomik në rajonin perëndimor të Kosovës.

AZhR-Perëndim kontribuon në fuqizimin e sektorëve të ndryshëm, si bujqësia, turizmi, dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

Unioni Ndërkombëtarë i Shoqatave të Udhëheqësve Malor (UIMLA)

UIMLA është një organ ndërkombëtar qeverisës i cili përfaqëson Udhëheqësit Ndërkombëtarë Malor në të gjithë botën. Një nga objektivat më të rëndësishëm për UIMLA është përfaqësimi i profesionit në nivel ndërkombëtar si dhe vendosja e standardeve të barabarta të kualifikimeve për të gjithë Udhëheqësit Ndërkombëtarë Malor (IML).

UIMLA promovon profesionin dhe mbështet bashkëpunimin ndërmjet IML-ve nga vende të ndryshme. Në muajin Nëntor 2024, Kosova është pranuar si anëtare kandidate në Unionin Ndërkombëtar të Shoqatave të Udhëheqësve Malor.

Projektet relevante të donatorëve

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)

Ky është projekti më i madh i përkrahur nga donatorët në industrinë e turizmit në Kosovë. Mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes PPSE, që implementohet nga Swisscontact dhe Riinvest. Qëllimi kryesor i këtij projekti në këtë sektor është që të rrisë numrin e turistëve, të cilët qëndrojnë më gjatë dhe shpenzojnë më shumë përmes intervenimeve që mbështesin zhvillimin e produkteve turistike, përmirësimin e atraksioneve turistike, promovimin e Kosovës dhe koordinimin e sektorit. Ky projekt ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Komunën e Pejës për zhvillimin e sektorit të turizmit në këtë rajon si vazhdimësi e bashkëpunimit që nga viti 2018. Në mesin e aktiviteteve të përbashkëta të parapara është edhe zhvillimi i kësaj strategjie. Projekti është në fazën e tretë të tij, e cila ka filluar nga viti 2018 dhe do të zgjasë deri në Nëntor të vitit 2025.

Gjithashtu në kuadër të projektit PPSE është bërë një hulumtim i produkteve turistike nga kompania konsulente franceze MDP në rajonin perëndimor të Kosovës me fokus në Komunitet e Pejës, Deçanit dhe Istogut. Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë identifikimit i produkteve turistike dhe zhvillimi i tyre i mëtutjeshëm. Në raportin e tyre “Mundësi për Biznes në Turizëm” përmenden 22 produkte të ndryshme si: Parku i Aventurave, Zip-line, Patinazhi Sintetik Lëvizës, Parku i Lojërave, Skijimi si dhe aktivitete tjera rrëshqitëse, Golf me Disqe, Kopshti Botanik etj¹⁴.

Swisscontact FEGO

Projekti “Nxitja e punësimit dhe mundësive të rritjes (FEGO)” synon të gjenerojë punësim dhe të ardhura për gratë, burrat dhe të rinjtë, të cilët aktualisht jetojnë në varfëri dhe marginalizim socio-ekonomik. Projekti synon të arrijë një rritje të qëndrueshme dhe të shkalëzuar të bizneseve mikro/të vogla (familjare) dhe bizneseve fillestare, në tre sektorë kryesorë ku është fokusuar projekti: veshje, mobilje dhe turizëm rural.

Projekti NATURKOSOVO

Projekti synon të ndihmojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në Kosovë duke promovuar seksionin lokal të Via Dinarica (120 km nëpër Parkun e Bjeshkëve të Nemuna), duke përmirësuar burimet e tij kulturore, historike dhe natyrore, duke mbështetur institucionet në

¹⁴ Strategjia Rajonale për Turizëm, Plan i Zbatimit 2016-2020

menaxhimin dhe qeverisjen e sektorit dhe krijimin e vendeve të punës në të mirë të komunitetit lokal. Ky projekt është një nismë e promovuar nga Aics Tirana dhe e realizuar nga CELIM dhe Volontari nel Mondo RTM, në bashkëpunim me Club Alpino Italiano (Klubi Alpin Italian), Corpo Nazionale soccorso alpino e speleologico (National Alpine and Caving Rescue Corps), Associazione Italiana turismo responsabile (Shoqata Italiane për turizmin e qëndrueshëm) dhe Fondacioni Utalaya.

Rural Tourism – Turning our villages into tourism destinations

Është një projekt mjaft atraktiv i cili ka filluar t'i vë themelet e turizmit rural në komunën e Pejës. Për këtë është duke u punuar gjithnjë për ngritjen e ofertës së eksperiencave rurale në zonat e rrafshita të Pejës dhe njëherit krijimi i një diversiteti më të madh turistik dhe lidhje të zonave turistike në mes veti në territorin e Pejës. Ky projekt financohet nga fondet EU-IPA në nivel ndërkufitarë - Malin e Zi - Kosovë.

Tourism for Future

Në vitin 2023, projekti ndërkufitar "Tourism for Future" ka synuar të transformojë rajonin e Pejës dhe Kolashinit në një qendër të turizmit të qëndrueshëm, duke rezultuar në një rritje të ndjeshme të numrit të vizitorëve dhe në zhvillimin e ofertave turistike në Pejë. Ky projekt financohet nga fondet EU-IPA në nivel ndërkufitarë - Malin e Zi – Kosovë.

6.3. Ambienti mundësues

Institucionet relevante në nivel qendror dhe lokal

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në Pejë luan një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe projekteve që mbështesin rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e sektorëve strategjikë, si turizmi, bujqësia, tregtia dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM). Përmes bashkëpunimit me aktorë lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik punon për të promovuar Pejën si një destinacion atraktiv për investime dhe turizëm.

Sektori i Turizmit

Fuqia bartëse e turizmit në Pejë është në këtë sektor dhe njëherit ky sektor shërben si DMO për komunën e Pejës. Sektori i Turizmit në Komunën e Pejës është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik lokal, duke u mbështetur në pasuritë e jashtëzakonshme natyrore dhe kulturore të rajonit.

Zyra për Informacion Turistik

Zyra për Informacion Turistik në Pejë është një pikë kyçe e informimit dhe asistencës për vizitorët që eksplorojnë qytetin dhe rajonin e Pejës. Kjo zyrë shërben si burim i rëndësishëm për të ofruar informacione mbi atraksionet turistike, aktivitetet, akomodimin, udhëzimet dhe ngjarjet lokale. Ajo ndihmon turistët të planifikojnë itineraret e tyre dhe të përfitojnë sa më shumë nga vizita e tyre në Pejë. Zyra bashkëpunon me operatorët turistikë lokalë, guidat turistike dhe bizneset që ofrojnë shërbime në fushën e turizmit për të siguruar një përvojë të cilësisë së lartë për turistët.

Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është institucioni përgjegjës për menaxhimin, mbrojtjen dhe promovimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna," një prej zonave më të rëndësishme natyrore në Kosovë dhe rajon. Kjo drejtori ka për mision të ruajë biodiversitetin unik, peizazhet malore, dhe pasuritë kulturore të kësaj zone, duke e zhvilluar atë si një destinacion të qëndrueshëm për turizmin ekologjik dhe aventuror.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Organi kryesor në nivel qendror që merret ekskluzivisht me sektorin e turizmit është Departamenti i Turizmit. Ky departament ka të punësuar 4 zyrtarë. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të këtij organi janë: propozimi, hartimi, dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit të turizmit; mbështetja në promovimin e Kosovës si destinacion turistik; ofron mbështetje për bashkëpunim me asociacionet ndërkombëtare të turizmit; dhe nxit aplikimin e standardeve të cilësisë për sektorin e akomodimit. Në anën tjetër, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) është organi përgjegjës për promovimin e turizmit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore është organi kryesor në nivel qendror sa i përket mbrojtjes, ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore. Nën ombrellën e këtij departamenti, operojnë tri divizione: Divizioni për Trashëgimi Arkitekturore dhe Arkeologjike, Divizioni për Trashëgimi të Luajtshme dhe Shpirtërore dhe Divizioni për Menaxhim të Integruar.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen, zhvillimin dhe koordinimin e politikave për administrimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në Kosovë. Kjo ministri luan një rol të rëndësishëm në promovimin e qeverisjes së mirë, decentralizimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të komunave për t'iu përgjigjur nevojave të qytetarëve.

Ministria e Zhvillimit Rajonal

Ministria e Zhvillimit Rajonal është institucion përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që mbështesin zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm në të gjitha rajonet e Kosovës. Kjo ministri ka për qëllim zvogëlimin e pabarazive rajonale, përmirësimin e infrastrukturës, fuqizimin ekonomik dhe përkrahjen e komuniteteve lokale përmes projekteve dhe iniciativave zhvillimore.

Qendra Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Pejë (QRTK)

QRTK në Pejë është organ në kuadër të MKRS-së. Roli i saj është promovimi, mbrojtja dhe hulumtimi në fushën e trashëgimisë kulturore në mënyrë të organizuar dhe sistematike. Në veçanti, qëllim i QRTK-së është inventarizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në Rajonin e Pejës.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI)

Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit, përkatësisht Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës që operon nën MMPH, është institucioni përgjegjës për krijimin e politikave për mbrojtje të ambientit dhe mbrojtje të natyrës.

Legjislacioni

Ligji për Turizmin

Ky ligj përcakton parimet, standardet dhe rregullat bazë për zhvillimin dhe promovimin e turizmit të qëndrueshëm në Republikën e Kosovës.

Ligji për Trashëgiminë Kulturore

Ky ligj ofron kornizën rregulluese për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Pjesa e territorit të Bjeshkëve të Nemuna si tërësi hapësinore e cila veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera të ruajtura, me numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peizazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo – arsimore, kulturore – historike, rekreative - turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kritereve mjedisore, shpallet Park kombëtar me emrin: Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”

Qeveria e Republikës së Kosovës me 28 dhjetor 2022, ka miratuar Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Ky dokument që përcakton parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën 10 vjeçare, ka për qëllim të mundësojë arrijtjen e synimeve dhe objektivave strategjike, përmes ndërmarrjes së veprimeve, masave dhe aktiviteteve të planifikuara në Plan. Rekomandimet dhe zhvillimet e propozuara do të ndikojnë drejtpërdrejtë në mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kësaj zone.

Plani Zhvillimor Komunal 2020-2028

Plani zhvillimor i Komunës së Pejës përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare. Nevoja për hartimin e një plani të ri është shfaqur jo vetëm si obligim i përmbushjes së kërkesave të ligjit të ri 04 / L-174 dhe akteve nënligjore të tij, por edhe për shkak të ndryshimeve evidente të kontekstit të cilat kanë ndodhur që nga aprovimi i PZHK/U –së në vitin 2007, kur edhe ishin miratuar ato plane.

Strategjia e Turizmit 2024-2030

Kjo strategji është hartuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në bashkëpunim me institucionet përkatëse, sektorin privat, akterët e fushëveprimtarive të turizmit dhe përfaqësues nga bashkëpunimi ndërkombëtar për zhvillim.

Strategjia e Turizmit 2024-2030 dhe Plani i Veprimit 2024-2026 ngërthen në vete 5 objektiva strategjike:

1. Rritja e aktiviteteve promovuese dhe përmirësimi i rrjedhës së informacionit.
2. Krijimi dhe avancimi i infrastrukturës cilësore dhe të qëndrueshme për zhvillim të turizmit.
3. Zgjerimi i ofertës turistike sipas standardeve të qëndrueshmërisë dhe rritja e konkurrueshmërisë.
4. Ngritja e kapaciteteve njerëzore për rritje të kuadrove në treg të punës dhe përmirësim të shërbimeve.
5. Avancimi i kornizës rregullative dhe të politikave të turizmit.

7. Pasqyra e rrjedhave të vizitorëve

Gjendja e turizmit në Komunën e Pejës është analizuar nën thjerrëzën e 7 rrjedhave strategjike të vizitorëve. Secila rrjedhë përbën një segment të caktuar të udhëtarëve, të cilët kanë motiv të caktuar dhe, deri diku, ndjekin aktivitet të ngjashëm.

Trajtimi i turizmit në nivel të rrjedhave, përveç tjerash, mundëson që të kuptohet më qartë profili i vizitorit, interaksioni i tij/saj me destinacionin, motivi dhe ndikimi i ardhjes, si dhe në përgjithësi oferta turistike me përparësitë dhe sfidat e saja.

Duke u mbështetur në këtë qasje, Tabela 3 tenton të ofrojë përgjigje për pyetjet e listuara më poshtë. Të kihet parasysh se të dhënat për këtë diagnozë të gjendjes janë mbledhur nga punëtoritë dhe nga takimet me disa akterë të turizmit, por jo nga një anketë me rigorozitet shkencor. Thënë këtë, të dhënat duhet trajtuar me kujdes.

Përparësitë dhe sfidat mund të përfshijnë më shumë se një rrjedhë të vizitorëve. Përgjigjia e pyetjeve na ofron informata dhe të dhëna për të kuptuar rëndësinë e rrjedhave për nga numri i vizitorëve por edhe për nga rëndësia e të ardhurave që ato flukse sjellin. Megjithatë, për t'u mos përsëritur, është tentuar që ato të paraqiten vetëm te rrjedha e cila është më së shumti relevante.

- Çfarë origjine kanë vizitorët?
- Çfarë moshe kanë ata/ato?
- Sa është kohëzgjatja e qëndrimit të tyre?
- Cilat janë aktivitetet kryesore të tyre?
- Çka i motivon ata/ato ta vizitojnë destinacionit?
- Çka e ka ndikuar ardhjen e tyre?
- Çka funksionon?
- Çka nuk funksionon/mungon?
- Cilat janë sfidat?

Tabela 3: Pasqyra e rrjedhave të vizitorëve

Emri i rrjedhës së vizitorëve	Profili (vendi i origjinës, moshë, niveli ekonomik, ditët e qëndrimit, potenciali shpenzues, periudha e vizitës etj.)	Motivi i vizitës (atraksioni dhe akterët kryesor)	Ndikuesi kryesor i vizitës	Çka funksionon? Cilat janë përparësitë?	Çka nuk funksionon/mungon? Cilat janë sfidat?
RV1: Turizmi i Aventurës, Bjeshkataria, Alpinizmi, Zip Line, Via Ferrata, Ngjitja, Shpella, Paragliding	Dominojnë vizitorët nga Gjermania, Zvicra, Holanda, Britania e Madhe, Austria, Polonia, Franca dhe SHBA. Vijnë si pjesë e toureve Ballkanike dhe në formë vetanake.	Aktivitetet në natyrë, alpinizëm, bjeshkatari, ecje, çiklizëm në natyrë.	Tour operatorët	Çmimet e volitshme.	Sezonë e shkurtër e punës; me ndërprerje.
	Vizitorë nga rajoni kryesisht Shqipëria dhe nga qytetet e ndryshme të Kosovës.	Kamping, eksperiencë, ngjitje/ climbing.	Paketat turistike të ecjeve ballkanike nga tour-operatorët nga	Mikpritja dhe miqësia e njerëzve.	Asfaltimi dhe shtrimi i rrugëve deri në zonat më të thella malore duhet të bëhet me kujdes, duke ruajtur ekosistemin dhe karakterin natyror të shtigjeve malore.
	Moshë e vizitorëve varion nga 20 deri në 70 vjeç.	Shijim dhe përjetim i natyrës.	Shqipëria dhe Mali Zi.	Gjatësia e shtigjeve	Në vend të asfaltimit të plotë të shtigjeve, mund të merren masa alternative për përmirësimin e
	Qëndrimi mesatar është 2-7 ditë.		Kombinimi i kulturës dhe natyrës.	Siguria që ofron vendi.	infrastrukturës, si shtresa të qëndrueshme ekologjike ose rrugë të përshtatura për transport të lehtë, pa dëmtuar peizazhin natyror.
	Periudha e vizitës: gjatë tërë vitit, por me flukse më të mëdha gjatë muajve Mars deri në Nëntor.	Ushqimi tradicional.		Krijimi i vendeve të reja të punës – hapja e	Largimi i turistëve
	Zakonisht udhëtojnë si individë/ vetëm. grupe të organizuara me miq.	Rrugëtimi i shtegut Peaks of the Balkans.		buftinave në zonat malore.	pasionant të natyrës (natyrës së egër) nga prishja e
	Shpenzime ditore 100 – 150 € për person.		Rrugëtimi i		

Vendet që vizitohen: Vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna si vazhdimësi e Alpeve Dinarike, Bjeshkët e Rugovës dhe majat të cilat janë pjesë e saj.	shtegut Via Dinarica Atraksionet e tjera: Via Ferrata, Ura Tibetiane dhe Zip Line	Afërsia me qytetin dhe qëndrimi për një natë në jetën e qytetit. Çertifikimi i guidave malore sipas standardit botëror – UIMLA - Union of International Mountain Leaders Mungon promovim i vazhdueshëm. Qasja e lehtë dhe e shpejtë e Shërbimit të Kërkim-Shpëtimit Malor të Kosovës	shtigjeve të ecjes dhe rregullimi/ shtrimi i tyre me rrugë automobilistike. Ndërtimet e pa kontrolluara, mbeturinat, prerja dhe shpyllëzimi e degradimi i vazhdueshëm i pyjeve. Infrastrukturë e dobët. Mungesë e transportit lokal i vazhdueshëm.
---	--	---	---

RV2: Festivalët dhe ngjarjet tjera

Arsyet kryesore të pjesëmarrjes në festival me tematika të ndryshme si: Anibar, Peja Outdoor, Jazz, Ranch Fest, Festivali i Ngjitjes, Lojërat Tradicionale, Festivali i Turizmit.	Pjesëmarrje në festivalët (tematike).	Promovimi në rrjete sociale.	Afërsia e qytetit me natyrën.	Krijimi i një kalendarit për festivalet dhe produkte të ngjashme, të cilat do të bënin që të jenë më të koordinuara dhe të shpërndara gjatë gjithë vitit.
Festivalet si Anibar, Peja Outdoor, Lojërat Tradicionale, etj janë festivale të cilat janë tashmë tradicionale në Pejë.	Krijimi i rrjeteve apo bashkëpunim ve profesionale.	Pjesëmarrës që kanë qenë më herët.	Fryma mikpritëse e qytetit.	Numri i madh i vizitorëve në periudha të shkurta
Mosha: 20 – 65 vjeç – gjithmonë varet nga tematika e festivalit që mbahet.	Shikimi i filmave që transmetohen në kinema të qytetit.	Promovimi përmes webfaqes të festivalit ndërkombëtar.	Stafi organizativ dhe angazhimi i të rinjve vullnetarë	Mungesë e kuadrit në kuadër të shërbimeve në gastronomi.
Pjesëmarrës apo vizitorët janë: vendas dhe ndërkombëtarë.	Përcjellja e aktivitetëve tjera	Sesionet informuese/ promovuese në rajon	Çmime të vizitorët ndërkombëtarë	Plan për mbrojtje të mjedisit dhe ulje të ndikimit negativ.
Koha e mbajtjes së tyre është gjatë sezonës pranverore, verore me kohëzgjatje nga 1 deri në 7 ditë.	përcjellëse që organizohen në kudër të festivaleve.	psh. Tiranë dhe Prishtinë	Aktivitetet të ndryshme natyrore.	Rritje e vëllimit të krijimit të mbeturinave.
Shpenzime ditore për person janë: 10 – 60 € (në bazë të tematikës).	Përfjetimi i atmosferës të veçantë që krijohet.			Mungesë e parkingjeve gjatë periudhave të festivaleve.
Qëndrimi i vizitorëve: 1 – 5 netë				Mos-angazhimi i guidave lokale për t'i vizituar atraksionet kulturore-historike të qytetit.

Plotësimi programit të festivaleve me aktivitete të tjera përciellëse.

Mungesa e transportit publik.

Krijimi i suvenireve tradicionale të ndërlidhura me festivalet.

Ndikim në ndotje të ambientit në zhurmë dhe mbeturinat.

Tualetet publike.

RV3:

**Vizitorët ditor
për trashëgimi
kulturore,
Çarshinë e
Gjatë dhe
Zejet**

Grupmosha madhore 30-70 vjeç	Vizita dhe njohje me monumente të trashëgimisë kulturore.	Tour-operatorët rajonal.	Hapësirat e trashëgimisë kulturore-historike nga periudha të ndryshme.	Qasja në Muzeun e Pejës jashtë orarit zyrtarë dhe zgjatja e orarit gjatë fundjavave në sezonin turistik.
Periudha: Gjatë gjithë vitit por dominojnë gjatë muajve Prill – Tetor	Njohje me historinë e qytetit.	Referenca nga ndërkombëtarët që kanë mision në Kosovë.	Distanca e afërt mes monumenteve kulturore-historike.	Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës – gjatë fundjavave dhe gjatë sezonit turistik.
Vizitorët janë kalimtarë – ditorë.	Zejet e vjetra, arkitektura e vjetër	Tour-operatorët nga Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria.	Mungesa e guidave kulturore të certifikuara.	
Vizitorë janë vendorë – të cilët janë nga qytete të ndryshme të Kosovës; Vizitorë nga rajoni, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi; Vizitorë ndërkombëtarë - Europë, Azi, Amerikë dhe vendet Arabe	autoktone shqiptare - shtëpi të tradicionale qytetare dhe ato në formë të kullave			
Qëndrim ditor 3 – 6 orë	Vizitojnë objekte të kultit dhe fetare.			Udhëheqja e tourit në Pejë nga guidat/udhërrëfyesit e huaj, jo ato vendase.
Atraksionet tjera kryesore: tërësia urbanistike e Çarshisë së Gjatë me Çarshi Xhaminë, kasha katolike Shën Katarina, Patrikana e Pejës, Muzeu e Pejës si dhe Mullirin e Haxhi Zekës,	Degustimi i ushqimeve tradicionale vendore.	Platformat online si psh. Booking.com	Standardi i lirë i jetës.	Marrja e masave nga inspektoriati i MINT për grupet pa udhërrëfyes/guida lokale.
Dyqanet zejtare dhe tregtarë		Nga vizitorët paraprak	Afërsia me shtetet fqinjë dhe shtetet e rajonit.	Numri i vogël i inspektorëve.
Vijnë: si individ, grupe të vogla				Numri i limituar i restoranteve që ofrojnë ushqim nga kuzhina tradicionale.

dhe të mëdha; apo edhe me familje.	Vizita, ecje, shëtitje në natyrë.	dhe vizitorë të rinj eksplorues të toureve Ballkanike nga Europa dhe Azia dhe më gjerë.	Digjitalizim të informatave mbi monumentet.
Shpenzimet: Mesatarisht 35 € për person.			Rregullimi i linjave të trafikut urban në përdorim nga turistët.
			Lidhja e aktiviteteve të trashëgimisë kulturore me ato natyrore për të zgjatur qëndrimin e turistëve ditorë.
			Mungesa e parkingjeve për autobusë.
			Mungesa e parkingut për auto-camping.
			Qentë endacak nëpër qytet.
			Siguria në trafik.
			Përmirësimi infrastrukturës.

**RV4:
Eksplorim dhe
ecje në natyrë**

Grupmosha: Të gjitha moshat pa përjashtim.	Misioni i fluksit: Eksplorimi botës bimore – shtazore; shpellave; liqeneve; ujëvarave dhe eksplorim për hulumtime shkencore.	Referenca nga hulumtues dhe eksplorues. Afërsia me qytetin dhe qëndrimi për një natë në jetën e qytetit.	Standardi i lirë i jetës. Mikpritja dhe miqësia e njerëzve. Siguria që ofron vendi.	Përmirësimi furnizimit me ujë. Menaxhimi ujërave të zeza. Degradimi, shpyllëzimi dhe dëmtimi i regjioneve endemike. Eksplorimi i një fluksi të madh vizitorësh mund të ketë një ndikim negativ në biodiversitet.
Kohëzgjatje: 2 - 4 netë qëndrimi	Motivi edukativ, hulumtues dhe shkencorë.	Certifikimi i guidave malore sipas standardit botëror – UIMLA - Union of Internationa l Mountain Leaders		
Udhëtojnë ose vijnë: në grupe të organizuara ose vetëm (për hulumtime shkencore) apo edhe të organizuar me familje.				
Periudha: gjatë gjithë vitit, duke shfrytëzuar natyrën gjatë sezonës verore por edhe dimërore.	Rekreacion, vizita, ecje, shëtitje në natyrë, pushim.			
	Burimi i Drint të Bardhë dhe Shpella e Radacit	Qasja e lehtë dhe e shpejtë e Shërbimi i Kërkim- Shpëtimit Malor i Kosovës		
	Degustimi i ushqimeve tradicionale			

vendore.

Njohje me
kulturën dhe
trashegiminë
e vendit.

RV5: Vizitorët nga diaspora, familjarët dhe shoqëria

Vijnë nga diaspora: Gjermania, Zvicra, Italia, Anglia, USA etj.	Takimi me familjarë.	Prindërit dhe familjarët në Kosovë.	Gatishmëria e të afërmeve për t'i shoqëruar gjatë qëndrimit.	Mos-respektimi i shenjave të komunikacionit dhe numri i madh i aksidenteve gjatë verës.
Grup moshë të ndryshme të rinj (student), moshë e mesme dhe të moshuar.	Festat e fundvitit.	Pushimet me familjarë;	Pushimet me familjarë;	Mungesa e toureve të krijuara enkas për diasporën.
Qëndrojnë 7 – 14 ditë (gjatë verës); 3 – 10 ditë (gjatë festave të fundvitit)	Pushimet verore.	Festat me familjet e gjëra.	natës.	Nuk ka promovim të mjaftueshëm të hapësirave kulturo-historike të qytetit.
Shpenzojnë rreth 100 – 150 € në ditë.	Ahengjet familjare.		Shërbimet e taksive dhe të veturave me qera.	Kostoja e lartë e fluturimeve.
Vendosen në pronat e tyre, te familjarët, te të afërmit, hotele dhe bujtina.	Vizita e të afërmeve dhe shoqërisë.		Numri i mjaftueshëm dhe cilësia e apartamenteve	Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe aktiviteteve tjera turistike.
Ushqehen në ambiente familjare – farestis, restorane dhe hotele.	Krijimi i shoqërisë dhe praktikimi i gjuhës.		Airbnb.	Mungesa e bashkëpunimit me shoqata të diasporës që operojnë në perëndim.
Preferohet të shërbehen ushqimet tradicionale të rajonit.				
Kanë potencial për shpenzime të larta.	Njohja me natyrën, kulturën, traditën.			Mos marrja e guidave lokale për përcjellja nga familjarët.

Frekuentim i

jetës së natës.
Vizita
kulturore
individuale.

Mbajtja e
lidhjeve me
vëndin e
originës.

RV6: Turizmi rural

Vizitorë nga Kosova, rajoni (Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Serbi), si dhe vende ndërkombëtare si Gjermania, Zvicra dhe Austria	Bukuritë natyrore si Bjeshkët e Nemuna, Gryka e Rugovës dhe fshatrat tradicionale	Referenca nga hulumtues dhe eksplorues.	Natyrtë të paprekur dhe shtigje të shumta për ecje	Promovimi i destinacioneve dhe aktiviteteve është i kufizuar, duke bërë që shumë atraksione të mbeten të panjohura
Grupmoshat 25-55 janë më të pranishme		Përvoja pozitive e miqve dhe familjarëve.	Ushqimi dhe kultura tradicionale, si dhe mikpritja e banorëve lokal	Ka nevojë për ngritje të kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve lokale për t'i përshtatur ato me kërkesat ndërkombëtare
Qëndrimi zakonisht varion nga një fundjavë (2-3 ditë) deri në një javë, veçanërisht për turistët ndërkombëtarë	Përvoja në natyrë dhe aktivitetet rurale si ecje, kamping, kajak, dhe peshkim janë atraksione kryesore			Në disa zona rurale, menaxhimi i mbetjeve dhe mbrojtja e mjedisit mbeten sfida serioze
Turistët shpenzojnë kryesisht në akomodim në bujtina tradicionale, ushqim lokal dhe aktivitete si ecje në natyrë, guidat kulturore dhe artizanale				
Sezoni kryesor është pranvera dhe vera	Aktivitete të tjera me rëndësi: Ditët e Boronicës; Darka e Lamës; Gjuetia; Festa e Mjaltit; Qethja e Deleve; Grumbullimi i çajrave të ndryshme			

Bujtinat
lokale, fermat
agroturistike,
dhe
komunitetet
lokale që
ofrojnë
përvoja
autentike si
përgatitja e
ushqimeve
tradicionale,
punime
artizanale dhe
guida
natyrore

RV7: Turizmi shëndetësor

Vizitorë nga diaspora kosovare që jetojnë në vendet evropiane, si Zvicra, Gjermania, dhe Austria por edhe në SHBA	Oferta e shërbimeve cilësore dhe me kosto të ulët në krahasim me vendet perëndimore	Rrjeti i diasporës dhe rekomandimet nga miqtë dhe familjarët	Klinikat dentare dhe hotelet në Pejë ofrojnë trajtime me kosto të ulët dhe standarde të larta profesionale.	Potenciali i turizmit shëndetësor nuk është promovuar sa duhet në tregjet ndërkombëtare.
Mosha mesatare 25–60 vjeç				Nuk ka oferta gjithëpërfshirëse që kombinojnë shërbime shëndetësore me aktivitete të tjera turistike në rajon.
Qëndrimi zakonisht varion 7-30 ditë duke kombinuar trajtimet shëndetësore me pushime.	Klinikat dentale në Pejë, të cilat ofrojnë trajtime si implantet, zbardhjen e dhëmbëve dhe ortodoncinë, janë ndër atraksionet kryesore			
Periudha më e zakonshme për vizita është gjatë pushimeve verore dhe festive, kur diaspora rikthehet në Kosovë.			Kombinim unik të trajtimeve shëndetësore dhe mundësi për aktivitete natyrore si ecjet në Bjeshkët e Nemuna dhe shëtitjet në Grykën e Rugovës.	
	Natyra e pasur e Pejës dhe shërbimet relaksuese si masazhet terapeutike në		Peja është e lehtë për t'u arritur nga qytetet kryesore të	

hotele janë
tërheqëse për
vizitorët që
kërkojnë të
kombinojnë
shëndetin me
mirëqenien.

Kosovës dhe
ka afërsi me
aerportin e
Prishtinës.

Duhet të kihet parasysh që edhe pse disa zona të Pejës aktualisht nuk shquhen për rrjedha të rregullta të vizitorëve, ato megjithatë, kanë filluar të jenë në planet investive të Komunës, për shkak të arsyeve në vijim:

- Diversifikimit të ofertës turistike;
- Infrastrukturës ekzistuese për zhvillim të aktiviteteve turistike;
- Traditës së zhvillimit të aktiviteteve turistike në të kaluarën; dhe
- Ofrit të mundësive të barabarta zonave të ndryshme për zhvillim të qëndrueshëm.

Në aspektin e potencialit zhvillimor turistik veçohet Zona turistike e Rugovës me lokalitetet turistike si: Gryka e Rugovës, Zona turistike e Liqenatit, fshatra Kuqishtë, Bogë, Drelaj, Reka e Allagës, Pepaj etj; Zona turistike e Podgurit dhe lokaliteti turistik i Burimit të Drinit – Radavci.

Si zona më karakteristike veçohen:

- Gryka e Rugovës - karakterizohet nga peizazhe mahnitëse, dhe mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve si ngjitje në shkëmbinjë, Via Ferrata, Zip-line, speleologji. Është porta hyrëse në parkun nacional Bjeshkët e Nemuna dhe qasja për shumë shtigje malore, përfshirë edhe ato ndërkufitare "Peaks of the Balkans dhe Via Dinarica."
- Zona turistike e Pejës duke përfshirë qendrën e qytetit të Pejës dhe 14 pikat tjera të trashëgimisë kulturore. Sheshi i qytetit ofron një përzierje interesante të arkitekturës tradicionale dhe moderne, ndërsa 14 pikat e trashëgimisë kulturore janë rrjedhë e historisë së zhvillimit në kohëra duke filluar nga periudha Ilire e deri në vitet e mëvonshme. Ndër to është edhe Patrikana e Pejës që është një kishë ortodokse nën mbrojtje të UNESCO-s
- Zona turistike e Podgurit me Burimin e Drinit të Bardhë, Ujëvara dhe Shpella e Radavcit - e vendosur pranë fshatit Radavc. Kjo ujëvarë me gjithë shpellën e Radavcit janë nga atraksionet natyrore më të njohura në Pejë dhe Kosovë, ndërsa pamjet që ofrohen nga ujëvara janë mahnitëse.
- Bjeshkët e Rugovës - zona alpine e Rugovës është perfekte për hiking, ski dhe eksplorim. Pothuajse të gjitha 13 fshatrat kanë specifika të caktuara natyrore dhe kulturore që i bëjnë atraktive për t'i vizituar dhe qëndruar aty.
- Maja Guri Kuq, Hajla dhe Maja e Çfërles – janë ndër majet më atraktive në Pejë dhe Kosovë që kalojnë lartësinë mbidetare mbi 2000m. Njëherit këto janë edhe maje atraktive dhe sfiduese për ngjite andaj janë të vizituara mjaft nga alpinistët me përvojë.
- Zona turistike e Lybeniqit – Është një fshat shumë atraktiv me mure të gurit në mënyrë tradicionale, ndërsa Kanioni i Lybeniqit është një vlerë natyrore e cila duhet të eksplorohej. Për këtë është futur edhe në planet turistike për t'u bërë fshat turistik.

- Zonat rurale - Fshatrat në zonat rurale kanë gjithashtu mundësi të ofrimit të produkteve turistike. Tani komuna ka filluar me implementimin e disa projekteve të cilat do të ngrisin vlerat turistike dhe duke i bërë të vizitueshme për vizitorët e Pejës.

Për këto lokacione, Komuna e Pejës parasheh hartimin e projekteve turistike, të cilat më pas do t'u ofrohen investitorëve potencial për bashkëfinancim ose investime vetanake.

“Peja e gjelbër dhe vitale”

Destinacion turistik, me lidhje të mira rajonale dhe ndër-kufitare. Nikoqire e ndërmarrësisë inovative konkurruese, me bujqësi dhe agroindustri të zhvilluar. Qendër rajonale e arsimit, kulturës, sportit dhe shëndetësisë, me mjedis cilësor, transport të qëndrueshëm dhe shërbime efikase¹⁵.

Vizioni i Komunës së Pejës për turizmin është të zhvillojë Pejën si një destinacion të qëndrueshëm dhe të njohur ndërkombëtarisht, duke promovuar pasuritë natyrore, kulturore dhe historike të saj, ndërkohë që nxit zhvillimin ekonomik lokal dhe ruan trashëgiminë unike të rajonit.

Objektivat strategjike

1. Turizmi i aventurës - Bjeshkataria, Alpinizmi, Zip Line, Via Ferrata, Shpella, Paragliding etj

- *Objektivi strategjik: Rritja e atraktivitetit të turizmit të aventurës në Pejë dhe Bjeshkët e Rugovës përmes zhvillimit dhe promovimit të shitjeve të sigurta dhe të mirëmbajtura, aktiviteteve si pushtimi i majave malore, eksplorimi i shpellave, Via Ferrata, Zip Line, biçiklizmi dhe paraglojdi, duke garantuar përvoja të veçanta dhe standarde të larta sigurie për entuziastët e natyrës dhe aventurës.*

2. Festivalet dhe ngjarjet tjera

- *Objektivi strategjik: Mbështetja dhe diversifikimi i kalendarit të festivaleve kulturore dhe artistike për të tërhequr vizitorë vendorë dhe ndërkombëtarë gjatë gjithë vitit.*

3. Vizitorët ditorë për trashëgimi kulturore, Çarshinë e Gjatë dhe Zejet

- *Objektivi strategjik: Rigjallërimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore të Pejës përmes mbrojtjes së monumenteve, zhvillimit të guidave interaktive dhe valorizimit të zejeve tradicionale, duke e pozicionuar Çarshinë e Gjatë si një destinacion kryesor për turizmin kulturor dhe artizanal.*

4. Eksplorim dhe ecje në natyrë

¹⁵ Plani Zhvillimor Komunal i Pejës 2020-2028

- **Objektivi strategjik:** Zhvillimi dhe promovimi i shtigjeve të ecjes dhe eksplorimit në natyrë në Destinacionin e Pejës, Bjeshkët e Rugovës, dhe Bjeshkët e Podgurit duke siguruar infrastrukturë të qëndrueshme, orientim të qartë, dhe përvoja unike për vizitorët, me fokus në ruajtjen e mjedisit dhe standardet e sigurisë.

5. Vizitorët nga diaspora, familjarët dhe shoqëria

- **Objektivi strategjik:** Krijimi i aktivitete dhe eventeve të personalizuar që forcojnë lidhjet e diasporës me vendlindjen dhe promovojnë atraksionet lokale për vizitorët familjarë.

6. Turizmi rural

- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit rural në Pejë, duke mbështetur agroturizmin, përvojat autentike në fshatra, dhe aktivitetet tradicionale, me qëllim të diversifikimit të ofertës turistike dhe krijimit të mundësive të qëndrueshme ekonomike për komunitetet lokale.

7. Turizmi shëndetësor

- Zhvillimi dhe promovimi i turizmit shëndetësor në Pejë, me fokus në shërbimet cilësore mjekësore dhe dentare, duke përfshirë nga potenciali i diasporës dhe duke krijuar oferta të integruara që kombinojnë kujdesin shëndetësor me përvojat relaksuese dhe natyrore të rajonit.

9. Veprimet e propozuara

Ky seksion shfaq veprimet që do të ndërmerren për t'i adresuar sfidat/problemet kryesore të identifikuara gjatë pasqyrimit të gjendjes. Këto veprime janë hartuar në konsultim me DZHE-në, dhe akterët e tjerë relevant. Gjithashtu, vlen të theksohet se veprimet janë në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028. Në shumicën e rasteve, veprimi përfshin më shumë se një rrjedhë të vizitorëve. Në Planin e Punës (në seksionin tjetër) dhe në Shtojcën A tregohet lidhja në mes të veprimeve të propozuara dhe rrjedhave të vizitorëve. Vlen të theksohet se radhitja e veprimeve nuk është bërë sipas rëndësisë së tyre.

Rrjedha e informacionit dhe promovimit

- Promovimi i Turizmit të Qëndrueshëm

Hartimi i politikave dhe standardeve për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, duke përfshirë mbrojtjen e burimeve natyrore dhe kulturore dhe organizimi i fushatave ndërgjegjëse për bizneset dhe vizitorët mbi rëndësinë e turizmit të qëndrueshëm¹⁶.

- Rritja e numrit të stafit në sektorin e turizmit

Rritja e numrit të stafit në sektorin e turizmit është një hap i domosdoshëm për përmirësimin e shërbimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e turizmit dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve.

- Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe të luajtshme

Organizimi i garave të ndryshme në shkollë si psh. gara të diturisë mbi trashëgiminë kulturore dhe shpirtërore të komunës së Pejës, gara artistike, gara të recitimit, ekskurzione në fundvit si p.sh vizita edukative në monumentet kulturore dhe ekskurzione në natyrë, ekspozita të vizatimeve, fotografive dhe aktivitete tjera shkollore.

- Platforma digjitale dhe promovim ndërkombëtar i turizmit në komunën e Pejës

Përditësimi i webfaqes për promovimin e vlerave natyrore e kulturore dhe ofertës turistike në komunën e Pejës (pikat shërbyese, kapacitetet etj) si dhe paraqitjet në faqet e internetit që promovojnë turizmin në nivel rajonal ndërkombëtar, si dhe në publikimet si magazina, broshura - guida turistike rajonale, etj.

- Promovimi dhe revitalizimi i trashëgimisë kulturore

Intervenimet e ndryshme për revitalizimin e trashëgimisë kulturore në komunën e Pejës

- Promovimi i turizmit të ujërave

¹⁶ PPSE (2024). Assessment of Sustainable Tourism Development Intervention Areas in Kosovo

Turizmi i ujërave paraqet një potencial të jashtëzakonshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Komunën e Pejës, duke shfrytëzuar pasuritë natyrore si lumenjtë dhe liqenet që karakterizojnë rajonin. Aktivitetet si kajaku dhe peshkimi jo vetëm që ofrojnë përvoja unike për vizitorët, por gjithashtu promovojnë ndërvlerësimin e natyrës dhe vlerësimin e ekosistemeve ujore. Në këtë drejtim mund të zhvillohen edhe oferta edukative si në sportin e kajakimit ashtu edhe në sportin e peshkimit dhe vetëdijësimin për mbrojtjen e lumenjëve.

- Promovimi i turizmit të errët

Turizmi i errët, një trend gjithnjë e më i njohur në industrinë globale të turizmit, ofron mundësi për të eksploruar destinacione të lidhura me historinë, trashëgiminë dhe ngjarje të kaluara me impakt të thellë emocional. Në kontekstin e Komunës së Pejës, ky lloj turizmi mund të zhvillohet duke promovuar lokacione dhe rreftime që lidhen me periudha historike të rëndësishme, ruajtjen e kujtesës kolektive dhe edukimin e vizitorëve për të kaluarën.

- Promovimi i turizmit rural

Organizimi i fushatave promociionale për të promovuar agroturizmin dhe përvojat tradicionale në fshatra.

- Organizimi i fushatave informuese/ndërgjegjëse për certifikatat e qëndrueshmërisë

Me qëllim që të arrijmë standarde më të mira për qëndrueshmërinë e destinacionit, strategjia parasheh që të zhvilloj fushata informuese / ndërgjegjëse për të gjithë destinacionin turistik (bizneset etj) të Pejës për mundësin e certifikimeve për qëndrueshmërinë me qëllim që të ngrisin mundësin e preznatimit sa më të mirë të Pejës në nivel global.

- Promovimi i turizmit shëndetësor

Organizimi i fushatave kombëtare dhe ndërkombëtare për të promovuar shërbimet shëndetësore të Pejës si destinacion për relaks dhe shërbime mjekësore.

- Mbështetja e tour-operatorëve lokal që të marrin pjesë në panairë ndërkombëtare

Tour-operatorët lokal nuk janë shumë të lidhur me tour-operatorë nga burimet kryesore të turizmit në Evropë. Për të pasur zhvillim të lidhjeve direkte me tour-operatorë në Evropë dhe për krijuar mundësi për të nënshkruar kontrata afatgjata, do të mbështet pjesëmarrja e vendorëve në panairë evropiane (si psh. "Destination Nature").

9.2. Transporti

- Hartimi i planit të mobilitetit

Analiza dhe vlerësimi i situatës aktuale të transportit dhe infrastrukturës për të identifikuar sfidat dhe mundësitë, organizimi i konsultimeve me qytetarët dhe palët e interesit për të kuptuar nevojat dhe prioritetet e tyre, si dhe zhvillimi i një vizioni strategjik për mobilitetin e qëndrueshëm që përfshin përmirësimin e transportit publik, shitigjeve për biçikleta dhe këmbësorë, si dhe integrimin e teknologjive të gjelbra për reduktimin e ndotjes.

- Promovimi i Ciklizmit

Zgjerimi, adaptimi dhe mirëmbajtja e shtigjeve të çiklizmit, sidomos në zona me potencial turistik si dhe organizimi i eventeve sportive dhe kulturore që promovojnë përdorimin e biçikletave. Tashmë janë në dispozicion 110 km shtigje të reja.

9.3. Atraksionet kulturore-historike

- Zhvillimi suvenireve dhe shitja e tyre në muze

Muzeu i vetëm në Pejë në funksion ka dyqan të integruar, i cili ofron suvenire/dhurata për vizitorët e interesuar por që nuk është një hapësirë e mjaftueshme. Me qëllim të adresimit të këtij problemi, fillimisht do të inicohet një proces për definimin e një game të suvenireve autentike. Vlerësohet e nevojshme të hapen edhe dy muze të tjera në mënyrë që të rriten atraksionet kulturore. Do të bashkëpunohet me MKRS-në që të nisët një proces i cili parasheh krijimin e hapësirave të suvenireve brenda/afër secilës hapësirë. Suveniret, përveç se do t'u ofrojnë vizitorëve një kujtim nga vizita e tyre, të hyrat që do të gjenerohen do t'u mundësojnë këtyre muzeve që t'i mbulojnë shpenzimet e tyre.

- Konservimi i monumenteve kulturore

Investime të pakta dhe të ngadalshme dhe ndonjëherë jo shumë strategjike në infrastrukturën turistike kulturore si p.sh. përqendrim në restaurim në vend konservimi, ngritje kapaciteteve njerëzore, etj.

- Ruajtja dhe rigjallërimi i zejeve tradicionale

Kujdes i pa mjaftueshëm për zejet tradicionale. Në Pejë artizanatet në rrezik shuarje janë mbështetur përmes një programi subvencioni nga Komuna por kjo është e paqëndrueshme. Prandaj është i nevojshëm krijimi i një strategjie afatgjatë për promovimin dhe mbrojtjen e zejeve tradicionale, përfshirë mbështetjen financiare të qëndrueshme, programe të trajnimit profesional për zejtarët dhe përfshirjen e zejeve në ofertën turistike të Pejës.

- Hulumtimi dhe evidentimi i shpellave

Fillimisht do të duhej evidentuar të gjitha shpellat në komunën e Pejës, ndërsa do të përzgjidheshin për gjurmime shpellat më atraktive. Gjurmime arkeologjike do duhej ndërmarrë në shpellën e Zezë, shpellën e Kallabës, shpellën e Kërshit të Kuq të rrethinës së qytetit të Pejës dhe shpellat në fshatrat dhe bjeshkë dhe podgurit (si: Lipë, Radavc, Jabllanice tw vogël dhe e Madhe, . Pas gjurmimeve arkeologjike do të krijoheshin kushtet që këto shpella t'u prezantohen turistëve të huaj dhe atyre vendas.

- Hulumtimi i kështjellave

Hulumtimi dhe prezantimi i katër kështjellave të antikitetit (kështjella e Lipës, Radacit, Lybeniqit dhe Jabllanicës së Madhe e ashtuquajtura sipas banorve kodra e Gjytetit).

- Promovimi i turizmit rural

Organizimi i toureave nga guidat lokale në monumentet historike rurale dhe vendet tradicionale si mullinjtë e ujit dhe fermat autentike (Mulliri i Bërdynajve).

9.4 Infrastruktura

- Menaxhimi i mbeturinave

Turistët synojnë vende të pastra ku mundësia e kanosjes së ndonjë infektimi është minimale. Mungesa e pastërtisë në hapësira publike është identifikuar si një nga problemet kryesore në hapësira publike nga turistët e huaj. Për ta ngritur nivelin e pastërtisë, do të sigurohet që menaxhimi i mbeturinave në hapësirat publike, sidomos ato afër lokacioneve turistike, të jetë sa më efikas.

- Stimulimi i ngritjes së kapaciteteve të pistave të skijimit

Zona malore e Rugovës ofron potencial të madh për zgjerimin e pistave të skijimit, me terrene të përshtatshme. Relievi dhe kushtet klimatike e bëjnë këtë zonë ideale për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit dimëror, duke krijuar mundësi për infrastrukturë të re dhe përmirësimin e shërbimeve për vizitorët. Për më tepër, pozita gjeografike dhe peizazhet e veçanta e bëjnë këtë destinacion tërheqës si për skijim, ashtu edhe për aktivitete të tjera rekreative në natyrë.

- Investimet në produkte për zhvillimin e turizmit të venturës

Peja në theks të veçant e ka zhvillimin e turizmit të aventurës andaj parasheh edhe investime të produkteve të ndryshme të aventurës të cilat do të ndikojnë në nxitjen e ofertës turistike. Për të zhvilluar këto produkte do të mbështetet në hulumtimin që është bërë nga SeissContact për zhvillimin e produkteve të turizmit të aventurës. Ndër to mund të përmendim RollCaster, Adventure park, summer sledging etj. Identifikimi i vendeve dhe llojit të produktit do të caktohet sipas kërkesës së orjentimit të rrjedhës së vizitorve.

- Ndërtimi i qendrës interpretuese e zhvillimeve ndër vite të Pejës

Peja ndër vite është projekt shumë i domosdoshëm për Pejën e sidomos për gjeneratat e reja të cilët nuk janë të njohur shumë me zhvillimin historik të Pejës. Kjo hapësirë do të jetë një mundësi ku shkollat, qytetarët dhe të gjithë vizitorët do të kenë mundësi të përjetojnë zhvillimet e Pejës ndër vite dhe të njihen më tepër me historinë e zhvillimeve të këtij qyteti. Njëherit kjo qendër do të ndikojë në zgjatjen e qëndrimit të vizitorve në Pejë e gjithashtu do të bjëjë Pejën më atraktive duke i shfaqur dhe vlerësuar vlerat e identitetit.

- Qendra për interpretim dhe zhvillim të qëndrueshëm "Lybeniqi"

Kjo do të funksionojnë si qendër për zhvillimin e projekteve të qëndrueshme të Pejës. Një hapësirë e cila do të tubojë përkrahës dhe iniciator të zhvillimit të qëndrueshëm, një pikë ku do të trajtohen temat e ambientit, një hapësirë për shkollë edhe shoqata për mbajtjen e aktiviteteve si dhe një mundësi për nxitje të zhvillimit të biznesit familjarë në zonën e fshatit të Lybeniqit.

- Qendra për interpretim dhe zhvillim të qëndrueshëm "Podguri"

Kjo do të funksionojnë si qendër për zhvillimin e projekteve të qëndrueshme të Pejës. Do të funksionojnë si një hapësirë e cila do të tubojë përkrahës dhe iniciator të zhvillimit të qëndrueshëm, një pikë ku do të trajtohen temat e ambientit, një hapësirë për shkollë edhe shoqata për mbajtjen e aktiviteteve si dhe një mundësi për nxitje të zhvillimit të biznesit familjarë në zonën e Podgurit.

- Ndërtimi i strehimoreve në bieshkët e Rugovës

Projekti ka filluar më heret në zonën e Podgurit dhe ka pasur sukses në ndërtimin e tri strehimoreve. Kjo ka treguar se ky projekt duhet të replikohet edhe në zonën e Rugovës duke krijuar infrastrukturë për zhvillim të qëndrueshëm e sidomos në parkun nacional Bjeshkët e Nemuna. Kjo infrastrukturë do të jetë në shërbim për turistët të cilët mund të gjenden jo të mira të motit, por gjithashtu si strehimore në rast të aksidentit dhe pikë informative ku mund të gjejnë informata ku të drejtohen për raste aksidenti.

- Akademia e çiklizmit në parkun e Karagaqit

Një projekt që do të përfshijë rinin në një vetëdijësim për shfrytëzimin e biçikletave çdo ditë por edhe do të promovojë Pejën si një destinacion i qëndrueshëm. Projekti parasheh që parkun e Karagaqit të ta shëndrojë në një hapësirë atraktive për akademikë e çiklizmit. Ky projekt do të tubojë shkollë dhe nxënëse të shkollave jo vetëm të Pejës por e gjithë Kosovës, do të mundësojë vizita familjare me fëmijë që ta frekuentojnë dhe ta përjetojnë ofertën e Pejës dhe të ndikojnë në promovimin e Pejës si destinacion i turizmit të aventurës.

- Kampi në Pejë

Mungesa e një kampi është e evidentuar si problem për Pejën që të jetë pjesë e kampeve ballkanike dhe evropiane. Sipas zyrës informative shumë vizitorë kërkojnë kampe por në mungesë të tyre detyrohen të dërgojnë afër ndonjë hapësirë të sigurt, ndonjë restorant apo ndonjë fshat. Për këtë strategji ka paraparë që të zhvillohet së paku një kamp në Pejë dhe të shërbejnë për masën e turistëve që kërkojnë këtë llojë oferte si dhe ta fusin Pejën pjesë të rrjetit të kampeve në Ballkan dhe Evropë.

- Fshatrat sportive në Pejë

Peja tashmë ka marrë emrin e qytetit të medaleve olimpike në sportin e xhudos dhe është bërë një brend për sporte. Për këtë Peja synon edhe tutje ta zhvillojë ofertën për të akomoduar sportistë të cilët do të zhvillojnë ushtrimet e tyre në sport. Kjo kërkon zhvillim të shërbimeve sportive ndërsa Peja është duke planifikuar që të zhvillojë zonë të caktuara të cilat do të ofrojnë shërbime specifike për të ofruar kushte për sporte.

- Qendra Rekreative dhe Turistike "Borea"

Qendra "Borea" në Pejë, konsiderohet mundësi e madhe për zhvillim. Kjo qendër ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit dimëror, me projekte që synojnë krijimin e infrastrukturës moderne për skijim dhe rekreacion. Një nga iniciativat kryesore përfshin

ndërtimin e një qendre turistike me kapacitete akomoduese, hapësira për shërbime dhe një sistem transporti që lidh vizitorët me pistat e skijimit. Aktualisht, projekti është në fazën e marrjes së lejeve për ndërtim, duke ofruar perspektiva të reja për zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë lokale.

9.5. Ngritja e kapaciteteve njerëzore

- Trajnimi i guidave kulturore dhe akterëve të shërbimeve kulinare që t'i përshtaten kërkesave të turistëve të huaj

Vizitorët e huaj, sidomos aziatikët, janë të interesuar në kuzhinë tradicionale. Duke pasur parasysh këtë, do të organizohet së paku një trajnim me instruktorë ndërkombëtarë për përfaqësuesit e kulinarisë në Pejë. Qëllimi i këtij trajnimi do të jetë aftësimi i pjesëmarrësve mbi përshtatshmërinë e kuzhinës/shërbimeve konform kërkesave të vizitorëve.

- Zhvillimi i profileve profesionale/zanateve

Hartimi i kurrikulave për profesione të specializuara, si tekniku i zërimit, në bashkëpunim me komunën, Anibarin dhe komunitetin dhe ofrimi i trajnimeve profesionale për zanate që lidhen drejtpërdrejt me turizmin dhe eventet kulturore.

- Trajnime për fermerët dhe pronarët e bujtinave mbi mikpritjen, marketingun dhe menaxhimin e turizmit.

Kjo pikë parasheh që të zhvillohen trajnime për fermerët dhe pronarët e bujtinave mbi mikpritjen, marketingun dhe menaxhimin e turizmit.

9.6 Produktet dhe aktivitetet turistike

- Bashkëpunimi me akomodimet/restorantet në Bjeshkët e Rugovës për mundësitë e diversifikimit të shërbimeve të tyre

Përjashtoj fjetjen dhe ushqimin, akomodimet/restorantet që operojnë në zonën e Rugovës përgjithësisht nuk ofrojnë ndonjë produkt shtesë turistik që do t'i bënte vizitorët të kalojnë më shumë kohë aty dhe t'i përjetojnë bukuritë e natyrës (p.sh. kalërimi). Në mënyrë që këto akomodime/restorante ta diversifikojnë veprimtarinë e tyre në funksion të promovimit të turizmit, plani është që fillimisht ato të informohen mbi këto mundësi si dhe të përkrahen përmes formave të bashkë-financimit dhe asistencës teknike.

- Organizimi i programeve kulturore gjatë vikendeve në sezonin e verës

Siç tregohet edhe nga norma e shfrytëzimit të akomodimeve, fluksi më i madh i vizitorëve në Pejë është gjatë periudhës së verës, sidomos i atyre nga diaspora. Për t'i argëtuar vizitorët, çdo javë do të organizohen programe artistike dy orëshe që përfshijnë ansamblet lokale dhe ato rajonale. Njëri nga lokacionet e përshtatshme për këto programe është Çarshia e Gjatë. Plan i për këto

festivale do të përgatitet në fillim të vitit, ku me ç'rast do të përgatitet edhe një kalendar, i cili do të promovohet nëpër platforma të ndryshme online.

- Organizimi i një tregu për festa të fundvitit

Me qëllim që destinacioni i Pejës të jetë edhe më atraktivë është paraparë që të zhvillohen aktivitete të llojit tregu të artizanateve gjatë muajit korrikë me qëllim që të krijohen ngjarje që atraktive gjatë kohës kur numri i vizitorve është më i madh në Pejë e gjithashtu kur diaspora është e pranishme. Ky aktivitet do të jetë vikendin e fundit të Korikut.

- Akomodim ndryshe

Akomodim ndryshe nga ai i zakonshmi (anglisht "tree houses" (shtëpi mbi drunj), open sky (fjetje nën qiell të hapur)¹⁷.

Akomodimet unike mund të ngrisin profilin e një destinacioni turistik si Peja, të mbështesin turizmin e qëndrueshëm dhe të ofrojnë përvoja të veçanta dhe të paharrueshme për mysafirët.

- Organizimi i festivaleve tradicionale dhe aktiviteteve sezonale si ditët e boronicës, festa e mjalitit, qethja e deleve, grumbullimi i çajrave të ndryshme, etj

Kjo pjesë është zhvillim i tutjeshëm i ofertës së turizmi rural. Ktu parashihet organizimi i festivaleve tradicionale dhe aktiviteteve sezonale si ditët e boronicës, festa e mjalitit, qethja e deleve, grumbullimi i çajrave të ndryshme, etj. Gjithashtu parasheh zhvillimi i itinerareve të ecjes dhe biçiklizmit që përfshijnë ndalesa në fermat rurale.

- Turizmi shëndetësor

Zhvillimi i paketave shëndetësore që përfshijnë kontrollë mjekësore, trajtime dentale dhe aktivitete relaksuese në natyrë dhe oferta tjera që mund të kenë lidhje me trajtimet shëndetësore.

- Zhvillimi i ofertës së turizmit të aventurës (ngjitje në shkëmbinjë, via ferrata, speologjia, zip line, dhe te ngjashme për ngritje të ofertës)

Zhvillimi i vazhdueshëm i atraksioneve të cilat ndikojnë në zhvillimin e turizmit të aventurës. Kjo përfshinë zgjerimin e shtrigjeve të ecjes, via ferrata, ngjitje në shkëmbinjë, zip line, speologji, kajak si dhe atraksione tjera të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e ofertës turistike të aventurës në Pejë.

9.7 Tjera

- Standardizimi i Mikpritjes

Hartimi i protokolleve për mikpritjen që sigurojnë një përvojë të qëndrueshme dhe cilësore për turistët dhe trajnimi i punonjësve të sektorit të turizmit mbi standardet e mikpritjes dhe sjelljes profesionale.

¹⁷ Hulumtim: Turizmi Rural në Rajonin Jugor të Kosovës, EC MA NDRYSHE, Prill 2023

- Hulumitim për stimulimin e ringjalljes së artizanaleve të vjetra të qytetit

Shumica a artizanaleve tradicionale të vjetra të qytetit nuk po arrijnë t'i rezistojnë dinamikave të reja të tregut dhe kështu ose janë shuar ose janë në prag të shuarjes. Në këtë kontekst është parë e nevojshme që fillimisht të bëhet një hulumtim për identifikimin e artizanateve të vjetra, të konstatohet gjendja e tyre, dhe të propozohen modalitetet për adaptimin e tyre në mjedisin e ri ekonomik.

- Sigurimi i të dhënave të sakta mbi numrin e vizitorëve dhe profilin e tyre (exit survey)

Ndonëse Peja është njëri nga destinacionet më të vizituara nga turistët, qoftë vendor apo të huaj, ende nuk ka statistika të besueshme të cilat e pasqyrojnë saktë realitetin në këtë sektor. Të dhënat e ASK-së tregojnë një fotografi të nën-vlerësuar të vizitorëve. Për të siguruar statistika të sakta mbi numrin e vizitorëve dhe mbi përvojën e tyre, do të bashkëpunohet me organizata/kompani hulumtimi që në baza të rregullta të bëjnë këto matje.

- Shpallja e muajit Korrik dhe Gusht si muaj të diasporës

Duke qenë se fluksi më i madh i të rinjve të diasporës është i koncentruar gjatë muajve korrik dhe gusht dhe duke ditur potencialin e tyre si segment, këta muaj do të shpallen "Muajt e Diasporës", ku me ç'rast do të ofrohen lehtësira rregulluese për akterët (psh. Zgjatje të orarit të punës).

- Krijimin e paketave për turizëm seminarik

Kongreset, seminarët, trajnimet dhe ngjarjet e tilla tjashme kryesisht organizohen gjatë muajve kur nuk ka pushime. Megjithatë në këta muaj ka më pak fluks të vizitorëve tipik në Pejë, akterët në anën e ofertës punojnë dukshëm nën kapacitetin e tyre. Për shembull, restorantet e dasmave dhe ahengjeve, kur përjetojnë sezonin e verës shumë pak shfrytëzohen. Për ta mbushur këtë hendek, do të inicohet bashkëpunim në mes të akomodimeve, restoranteve dhe akterëve tjerë që të zhvillojnë paketa atraktive për turizëm seminarik (infrastrukturë të përshtatshme, çmime të volitshme, ture kulturore dhe natyrore etj.) dhe t'i promovojnë ato përmes kanaleve të ndryshme promovuese.

- Programi bashkëpunimi dhe shkëmbimi

Zhvillimi i programeve për shkëmbim kulturor dhe natyror dhe bashkëpunime me shtete të ndryshme, përfshirë organizimin e eventeve ndërkombëtare në Pejë dhe krijimi i partneriteteve për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e turizmit.

- Krijimi i tregut dhe dyqanit Bio-Organik për produkte lokale në Pejë

Të organizohet një treg apo sektor i veçantë i produkteve bujqësore e blegtorale lokale duke përfshirë stimulimin e ngritjes së një dyqani bio-organik (investim privat) si në qytetet tjera ekologjike (shembuj nga rajoni) për modele dhe shkëmbim eksperience¹⁸.

18. Planë e qytetit

Veprimet e identifikuar	Rrjedha e vizitorëve të synuar	Prioriteti (1 = i lartë; 2 = mesatar; 3 = i ulët)	Përgjegjësit për implementim/ndihmë ¹⁹	Buxheti Orientues (EUR)	Plani kohor																			
					2026				2027				2028				2029				2030			
					1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
					1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4

Rrjedha e informacionit dhe promovimi

Hartimi i politikave dhe standardeve për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, DKRS, MINT	30,000												
Rrija e numrit të stafit në Sektorin e Turizmit	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE	17,184												
Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe të luajtshme / Organizimi i garave të ndryshme në shkollë	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, DKRS	50,000												
Përditësimi i platformës digjitale dhe promovim ndërkombëtar i turizmit në komunën e Pejës	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE	20,000												
Promovimi dhe revitalizimi i trashëgimisë kulturore	RV3	1	DZHE	250,000												
Promovimi i turizmit të ujërave	RV1	2	DZHE, Operatori privat	50,000												
Promovimi i turizmit të errët	RV3	3	Komuna e Pejës, MKRS	50,000												
Organizimi i fushatave	RV6	1	Komuna e Pejës, Organizatat, Donoret	50,000												

¹⁹ Aktet e tjera përveç komunës janë identifikuar si bashkëpunëtorë potencial, por nuk do të thotë që patjetër do të angazhohen apo mbështesin zbatimin e masës së caktuar.

Investimet në produkte për zhvillimin e turizmit të venturës	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët, biznesi privat	500.000	
Ndërtimi i qendrës interpretuese e zhvillimeve ndër vite të Pejës	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët, biznesi privat	250.000	
Qendra për interpretim dhe zhvillim të qëndrueshëm "Lybeniqi"	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët,	110.000	
Qendra për interpretim dhe zhvillim të qëndrueshëm "Podguri"	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët,	100.000	
Ndërtimi i strehimoreve në bishkët e Rugovës	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët,	50.000	
Akademia e çiklizmit në parkun e Karagaqit	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët,	200.000	
Kampi në Pejë	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët,	50.000	
Fshatrat sportive në Pejë	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Organizatat, donatorët,	500.000	
Ngritja e kapaciteteve njerëzore					
Trajnimi i guidave kulturore dhe akterëve të shërbimeve kulinare që t'i përshkruajnë kërkesave të turistëve të huaj	Të gjitha rrjedhat	2	DZHE, Organizatat dhe donatorët	40.000	
Zhvillimi i profileve profesionale / zanateve	Të gjitha rrjedhat	2	DZHE, Organizatat dhe donatorët	45.000	
Trajnime për fermerët dhe	RV6	1	Komuna e Pejës,	40.000	

<i>pronarët e bujtinave mbi mikpritjen, marketingun dhe menaxhimin e turizmit.</i>	Organizatat dhe donatorët		
Produktet dhe aktivitetet turistike			
<i>Bashkëpunimi me akomodimet/restorantet në Bjeshkët e Rugovës për mundësitë e diversifikimit të shërbimeve të tyre</i>	RV1, RV5, RV7	2 Sektori privat, Donatorët	250,000
<i>Organizimi i programeve kulturore gjatë vikendeve verës</i>	RV3, RV6, RV7	2 DZHE, DKRS, Organizatat dhe Donatorët	100,000
<i>Organizimi i një tregu për festa të fundvitit</i>	RV6, RV7	1 Komuna e Pejës, Operatori Privat	100,000
<i>Akomodim ndryshe (tree houses)</i>	RV5	2 Komuna e Pejës, donatorët	300,000
<i>Organizimi i festivaleve tradicionale dhe aktivitetëve sezonale si ditët e boronicës, festa e mjalit, qethja e deleve, grumbullimi i çajrave të ndryshme, etj</i>	RV6	1 DZHE, organizatat, donatorët, Sektori privat	150,000
<i>Zhvillimi i paketave shëndetësore që përfshijnë kontrolle mjekësore, trajtime dentale dhe aktivitete relaksuese në natyrë</i>	RV7	2 DZHE, Sektori privat	50,000

Zhvillimi i ofertës së turizmit të aventurës (ngjitje në shkëmbinjë, via ferrata, speologjia, zip line, dhe te ngjashme për ngjitje të ofertës)

RV1

DZHE, Sektori privat

300.000

Tjera

Standardizimi i Mikpritjes	Të gjitha rrjedhat	1	Komuna e Pejës, Sektori privat	50,000	
Hulumtim për stimulimin e ringjalljes së artizanaleve të vjetra të qytetit	RV4, RV6	2	DZHE, Donatorët, Sektori privat	20,000	
Sigurimi i të dhënave të sakta mbi numrin e vizitorëve dhe profilin e tyre (exit survey)	Të gjitha rrjedhat	2	DZHE, Institucionet arsimore, Sektori privat	10,000	
Shpallja e muajit Korrik dhe Gusht si muaj të diasporës	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Donatorët, Sektori privat	300,000	
Krijimi i paketave për turizëm seminarik	Të gjitha rrjedhat	2	Komuna e Pejës, Donatorët, operatorët privat	100,000	
Programe bashkëpunimi dhe shkëmbimi	Të gjitha rrjedhat	1	DZHE, Akterët e Turizmit, Donatorët	350,000	
Krijimi i tregut dhe dyqanit Bio-Organik për produkte lokale në Pejë	RV6, RV7	2	DZHE, Operatorët privat	50,000	

11. Matja e performancës dhe implementimi

Si pjesë të implementimit të strategjisë, Komuna e Pejës do të lehtësojë një proces të vazhdueshëm të matjes së performancës, ku në mënyrë periodike do të vlerësohet progresi i përgjithshëm në drejtim të zhvillimit të sektorit si dhe zbatueshmëria e strategjisë.

Në mënyrë që matja të jetë më konkrete, janë zhvilluar një bashkësi indikatorësh, të cilët përgjithësisht përkojnë me rrjedhat dhe veprimet e propozuara në këtë strategji.

Tabela 4: Indikatorët për matje të performancës

Kategoria	Indikatorët matës
Numri i vizitorëve	• Norma e shfrytëzimit të njësive akomoduese (%) • Numri i përgjithshëm i vizitorëve (#) • Numri i eksploruesve perëndimor të trashëgimisë kulturore (#) • Numri i vizitorëve nga Shqipëria gjatë vikendeve (#) • Numri i eksploruesve të rinj nga diaspora (#) • Numri i vizitorëve të Anibar me qëndrim të gjatë (#) • Numri i vizitorëve të Bjeshkëve të Rugovës për aktivitete dimërore (#) • Numri i vizitorëve aziatik në toure ballkanike (#) • Numri i pjesëmarrësve në seminare të punës (#) • Numri i gurpeve që bëjnë hiking në Bjeshkët e Rugovës (#) • Numri i vizitorëve që bëjnë shopping për ahengje familjare
Kohëzgjatja e qëndrimit	• Kohëzgjatja e qëndrimit sipas kategorive të vizitorëve (# i ditëve)
Shpenzimet	• Shpenzimet e përgjithshme të udhëtimit sipas kategorive të vizitorëve (€) • Shpenzimet për udhëtim sipas kategorive të vizitorëve (€) • Shpenzimet për akomodim sipas kategorive të vizitorëve (€) • Shpenzimet për ushqim dhe pija sipas kategorive të vizitorëve (€) • Shpenzimet për aktivitete argëtuese dhe rekreacionale sipas kategorive të vizitorëve (€) • Shpenzimet për shopping (€) • Shpenzimet për paketa turistike (€)
Vendet e reja të punës	• Numri i përgjithshëm i vendeve të punës të krijuara nga aktivitetet turistike (€) • Numri i vendeve të punës i krijuar në njësi akomoduese (#) • Numri i vendeve të punës i krijuar në restorante kafe, shopping (#) • Numri i vendeve të punës te tour-operatorët (#)

Përvoja e udhëtimit

Zbatueshmëria e veprimeve

- Niveli i kënaqshmërisë së vizitorëve me komplet përvojën (%)
- Niveli i kënaqshmërisë së vizitorëve me akomodimin (%)
- Niveli i kënaqshmërisë së vizitorëve rrjedhën e informatave (%)
- Niveli i kënaqshmërisë së vizitorëve me përvojat kulturore (%)
- Zhvillimi i një pyetësoi të brendshëm që do të vlerësojë se në çfarë faze është implementimi i secilit veprim. Notimi do të jetë si vijon: 1 – nuk ka filluar; 2 – është implementuar pjesërisht; 3 – është implementuar në plotësisht.

Efektiviteti i një strategjie varet shumë nga qasja dhe koordinimi në implementim të saj. Në mënyrë që implementimi i këtij dokumenti të shkojë konform planifikimeve, duke përfshirë të gjitha palët e parapara, do të propozohet një mekanizëm i veçantë. Ndonëse modaliteti i funksionimit të këtij mekanizmi pritet të saktësohet nga DZHE, roli i tij në parim do të jetë që të:

- Monitorojë dhe vlerësojë progresin në implementim të strategjisë;
- Inicijojë bashkëpunim me aktorë tjerë relevantë në zbatim të masave të propozuara;
- Përditësojë strategjinë sipas zhvillimeve dhe dinamikave në të ardhmen;
- Informojë palët e interesit mbi progresin;
- Ekzekutojë aktivitete tjera të nevojshme që lidhen me strategjinë.

Shtojcat

Shtojca A²⁰

Veprimet e Propozuara	RV1: Bjeshkatari a, Alpinizmi dhe Turizmi i aventurës - Zip Line, Via Ferrata, Shpella, Paragliding	RV2: Festivalet dhe ngjarjet tjera	RV3: Vizitorët ditorë për trashëgimi kulturore, Çarshinë e Gjatë dhe Zejet	RV4: Eksplorim dhe ecje në natyrë	RV5: Vizitorët nga diaspora, familjarët dhe shoqëria	RV6: Turizmi rural	RV7: Turizmi shëndetës or
-----------------------	--	--	---	--	--	--------------------------	------------------------------------

Rrjedha e informacionit dhe promovimi

Hartimi i politikave dhe standardeve për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm	++	++	+	+++	++	+++	++
Ritja e numrit të stafit në Sektorin e Turizmit	+++	+++	+++	+++	+++	+++	+++
Promovimi i trashëgimisë shpirtërore dhe të luajtshme / Organizimi i garave të ndryshme në shkollë	+	+	+	+++	+	+++	++

²⁰ Kjo tabelë tregon lidhjen e veprimeve të propozuara me rrjedhën e vizitorëve. Nëse celula është e zbrazët, veprimi nuk ka ndikim; ++ ka pak ndikim; +++ ka mesatarisht ndikim, +++ ka shumë ndikim.

Përditësimi i platformës digjitale dhe promovim ndërkombëtar i turizmit në komunën e Pejës	+++	+++	++	+++	++	+++	+
Promovimi dhe revitalizimi i trashëgimisë kulturore	+	++	+++	+	+++	+	+
Promovimi i turizmit të ujërave (kajak, peshkim)	+++	++	+	+++	+	++	+
Promovimi i turizmit të errët	+		+		++		
Organizimi i fushatave promionale për të promovuar agroturizmin dhe përvojat tradicionale në fshatra	+++	+	+++	+++	++	+++	++
Organizimi i fushatave informuese/ndërgjegjë suese për certifikatat e qëndrueshmërisë	+++	++	+			+++	
Organizimi i fushatave ndërkombëtare për të promovuar shërbimet shëndetësore të Pejës si destinacion për relaks dhe shërbime mjekësore	++	++	+++	++	+++	+	+++

Mbështetja e tour-operatorëve lokal që të marrin pjesë në panairë ndërkombëtare	+++	+++	+++	+++	+++	+++	+++	+++
Transporti								
Hartimi i planit të mobilitetit	+++	+++	+	++	+++	++	++	++
Promovimi i Çiklizmit			+++	+++		+++	+++	++
Atraksionet kulturore-historike								
Zhvillimi suvenireve dhe shitja e tyre në muze	+		++	+++		+++	+++	++
Konservimi i monumenteve kulturore			+	++		++	++	
Ruajtja dhe rigjallërimi i zejeve tradicionale			+	+++		+++	+++	++
Hulumtimi dhe evidentimi i shpellave	+++	+++			+++			++
Hulumtimi i kështjellave	++	+			+			
Organizimi i toureve nga guidat lokale në monumentet historike rurale dhe vendet tradicionale si mullinjë e ujit dhe ferman autenike	++	++	++	++		++	++	+

<i>(Mulliri i Bërdynajve)</i>									
Infrastruktura									
Vendosja e shportave për hedhje të mbeturinave në hapësira publike	+++	+++	+++	+++	+++	+++	+++	+++	++
Stimulimi i ngritjes së kapaciteteve të pistave të skijimit	+++		++						
Investimet në produkte për zhvillimin e turizmit të venturës	+++	+++	++	++	++	++	++	++	+
Ndërtimi i qendrës interpretuese e zhvillimeve ndër vite të Pejës	+++	++	++	++	++			++	
Qendra për interpretim dhe zhvillim të qëndrueshëm "Lybeniqi"	+++	++	++	++				+	
Qendra për interpretim dhe zhvillim të qëndrueshëm "Podguri"	+++	++		++			+	+	
Ndërtimi i strehimoreve në bjeshkët e Rugovës	+++	+++		++			++	+	

Akademia e çiklizmit ne parkun e Karagaqit	++	++	++		++	++	++
Kampi në Pejë	+++		++	+		++	
Fshatrat sportive në Pejë	++		++		++	+	

Ngritja e kapaciteteve njerëzore

<i>Trajnimi i guidave kulturore dhe akterëve të shërbimeve kulinare që t'i përshtaten kërkesave të turistëve të huaj</i>	+	+	++	+++	++	++	++
Zhvillimi i profileve profesionale/zanateve			+	++	+++	++	
Trajnime për fermerët dhe pronarët e bujtinave mbi mikpritjen, marketingun dhe menaxhimin e turizmit	++					+++	

Produktet turistike

Bashkëpunimi me akomodimet/restorante të Bjeshtë e Rugovës për mundësitë e	+++	+++		+++			++
--	-----	-----	--	-----	--	--	----

[illegible]

Hulumtim për stimulimin e ringjalljes së artizanaleve të vjetra të qytetit			+	++		++	+
Sigurimi i të dhënave të sakta mbi numrin e vizitorëve dhe profilin e tyre (exit survey)	+++	+++	+++	+++		+++	+++
Shpallja e muajit Korrik dhe Gusht si muaj të diasporës			+	+			
Krijimin e paketave për turizëm seminarik	++	++	+++	+		++	++
Programe bashkëpunimi dhe shkëmbimi	+++	++	+	+		+++	++
Krijimi i tregut dhe dyqanit Bio-Organik për produkte lokale në Pejë	+++	+++	+++	++		+++	+

2025